



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË RRJETIN AKADEMIK SHQIPTAR

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT NË RRJETIN AKADEMIK SHQIPTAR

Tiranë, Maj 2023

PËRMBAJTJA

Nr.	EMËRTIMI	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
3.	Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit	7
II.	HYRJA	
1.	Objekti i auditimit	7
2.	Qëllimi i auditimit	7
3.	Identifikimi i çështjes	8
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	8
5.	Përgjegjësitë e audituesve	8
6.	Kriteret e vlerësimit	9
7.	Standardet e auditimit	9
8.	Metodat e auditimit	9
9.	Dokumentimi i auditimit	9
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
1.	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	10
2.	Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit	
2.1	Auditimi i programeve “Software” që ofrojnë shërbime, për arsimin e lartë dhe parauniversitar, agjencitë e varësisë si dhe kërkimit shkencor dhe inovacionit.	13-34
2.2	Siguria, ruajtja e informacionit si dhe ndërveprimi për bazat e të dhënave që janë krijuar apo administrohen nga RASH.	34-41
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	
A.	Masat Organizative	42-47

✂ LISTA E SHKURTIMEVE

KLSH	- Kontrolli i Lartë i Shtetit
RASH	- Rrjeti Akademik Shqiptar
MASR	- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
IAL	- Institucionet e Arsimit të Lartë
AKSHI	- Agjensia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit
VKM	- Vendim i Këshillit të Ministrave
TIK	- Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
TI (IT)	- Teknologji Informacioni
BCP	- Business Continuity Plan
BCC	- Business Continuity Center
DRC	- Disaster Recovery Center
IP	- Internet Protocol
VPN	- Virtual Private Network
LAN	- Local Area Network
VLAN	- Virtual Local area network
MFK	- Menaxhimi Financiar dhe Kontrollit

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

KLSH mbështetur në Ligjin nr.154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi një auditim mbi teknologjinë e informacionit në RASH, nga data 06.02.2023 deri më datë 07.04.2023.

Grupi i auditimit mblodhi informacione, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në këto informacione hartoi drejtimet e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi me objekt “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit”, në RASH, është pjesë e Planit Vjetor 2023 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH.

Përzgjedhja e këtij subjekti, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, që ka zhvilluar dhe mirëmban RASH, duke ju ofruar MASR-s dhe IAL-ve zgjidhje të informatizuara të procesve të tyre akademike dhe administrative.

Pas marrjes së ambienteve të përshtatshme, grupi auditues filloi fazën e studimit paraprak, ku u dërgua pyetësori i hartuar nga grupi i auditimit, bazuar në Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Programi i auditimit me nr. 74/1, u miratua nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me datë 06.02.2023.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetjet kryesore, të paraqitura në këtë Raport Përfundimtar Auditimi në mënyrë të përmbledhur sipas drejtimeve të auditimit, rezultuan si më poshtë:

Nr.	Përmbledhje e Gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1	<i>Nga auditimi u konstatua se Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe IAL-të, e kanë vendosur Rrjetin Akademik Shqiptar në kushtet e riskut të ekzistencës së tij, pasi nuk kanë financuar për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemeve informatike që j'u ka ofruar, në kundërshtim me VKM nr.88, datë 14.02.2018, në pikën 5.</i>	faqe 13-34	e lartë	Rekomandimi: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Institucione e Arsimit të Lartë, si anëtarë të asamblesë së Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për të vënë në funksion të administrimit të tyre akademik dhe administrativ produktet informatike që janë zhvilluar nga RASH si asete të rëndësishme në drejtim të inovacionit dhe të bashkëpunojnë në mënyrë aktive në përmirësimin e tyre, pasi vetëm në këtë mënyrë do të mund të informatizojnë më shumë procese dhe me

				më pak kosto financiare.
2	<p>Nga auditimi mbi sistemin “Mësues për Shqipërinë”, u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tek “Regjistrimi”, mësuesi hap llogarinë personale për herë të parë. Për ngarkimin e dosjes është konceptuar një fushë në të cilën bashkëngjitet duke upload-uar dokumentet që mësuesi dorëzon në aplikim. Për t’ju ardhur në ndihmë përdoruesve që në këtë rast janë mësues, është vendosur një tutorial i cili udhëzon në anglisht se si të bëhen “zip” dokumentet për aplikim, gjuhë e cila nuk njihet nga çdo mësues. - Nuk janë implementuar kontrole mbi datën e lindjes së mësuesit që plotësohet në regjistrimin fillestar të tij, që do të thotë se të dhënat e datës së lindjes mund të jenë çfarëdo. - Në fushat që plotëson mësuesi për Emrin, Atësinë dhe Mbiemrin nuk janë implementuar kontrole të karaktereve numerike apo speciale, pra këto të dhëna mund të plotësohen duke vendosur karaktere të tipit: ‘,/] etj. - Fushat e detyrueshme nuk janë identifikuar me tregues specifik si “*” apo ngjyrë tjetër, e cila i tregon përdoruesit, se nuk mund të vazhdojë më tej pa bërë plotësimet e nevojshme. Për plotësimin e fushave të detyrueshme nuk janë implementuar kontrole me plotësimin e tyre hap pas hapi. Një kontroll është implementuar në butonin e fundit “regjistrohu”, që shërben për ruajtjen e aplikimit. - Numri personal me numrin e pasaportës janë konceptuar në të njëjtën fushë, por këto dy numra nuk kanë të njëjtin format. Nisur nga kjo, nuk implementohen dot kushte parandaluese në hedhjen e të dhënave të sakta për formatin e NID-it dhe numrit të pasaportës. - Nuk është vendosur një maskë orientuese për numrin që nevojitet të plotësohet nga përdoruesi si në rastin e datëlindjes. - Me zgjedhjen e opsionit “Konfirmo s ‘kualifikimin / përjashtimin e kandidatit”, nuk ka një fushë të detyruar ku të jepen arsyet e refuzimit nga DRAP, të dhëna të nevojshme për DPAP- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar. - Fusha “Shënim” është e njëjta fushë ku mund të shkruajnë apo ndryshojnë të gjitha nivelet e përdoruesve: DRAP – Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, DPAP- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe ZVAP- Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar. Pra, në këtë fushë shënimimi i kryer nga DRAP mund të ndryshohet nga DPAP apo ZVAP dhe 	faqe 13-34	e lartë	<p><u>Rekomandimi:</u></p> <p>Drejtuesit e institucionit të Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga auditimi në sistemin “Mësues për Shqipërinë”, me qëllim përmirësimin, strukturimin dhe unifikimin e të dhënave hyrëse, duke minimizuar në këtë mënyrë parregullsi të përdoruesve dhe nevojën për suport.</p>

	anasjelltas, çfarë pengon shënimet të mbeten si rekorde për efekt kontrolli apo gjurme në secilën nga fazat e vlerësimit.			
3	<p>Nga auditimi mbi sistemin “Portali i Trajnimeve”, u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tarifa e trajnimit është një e dhënë që plotësohet nga agjencitë kur shtojnë një rekord të ri për trajnimin i cili më pas publikohet në portal. Në këtë fushë mund të shënohen dhe tekst megjithëse me këtë të dhënë nevojiten të zhvillohen statistika nga ana e RASH. - Gjatë regjistrimit mbi llojin e trajnimit mundësitë e zgjedhjes janë: i Drejtpërdrejtë, online dhe i kombinuar. Këto opsione megjithëse fikse dhe të dërguara nga KAPT-Komisioni i Akreditimit të Programit të Trajnimit, nuk rezultojnë të jenë pjesë e një liste nga e cila agjencitë të mund të zgjedhin po ata e plotësojnë këtë të dhënë manualisht. - Orari i fillimit dhe Orari i mbarimit është i tipit tekst, ndërkohë që duhet të ishte “Time”. - KAPT-i dërgon të dhënat për modulet si dhe të dhënat për agjencitë ku në disa raste janë në anglisht. RASH nuk ka ndërtuar një model “template” për plotësimin e fushave me të dhëna që vijnë nga KAPT-i, duke përcaktuar në këtë mënyrë se cilat janë të dhënat e detyrueshme që nevojiten për sistemin e trajnimeve. - Përdoruesit e të gjitha kategorive nuk gjenerojnë të dhëna si output/raporte. - Në aplikimin për trajnim që kryhet nga mësuesi të dhënat hyrëse për emrin, mbiemrin dhe numrin personal janë formatuar në tipin tekst, që do të thotë se si të dhëna lejohet të regjistrohen karaktere speciale. - Mesazhi që del në aplikimin e mësuesit për zhvillimin e një trajnimi është se “<i>Të gjitha fushat janë të detyrueshme për t’u plotësuar</i>”, por aplikimi mund të ruhet pa plotësuar të dhëna mbi Institucionin Arsimor. 	faqe 13-34	e lartë	<p>Rekomandimi: Drejtnesit e institucionit të Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për sistemin e problematikave të konstatuara në sistemin “Portali i Trajnimeve”, duke përmirësuar në këtë mënyrë strukturimin dhe unifikimin e të dhënave hyrëse e njëkohësisht duke minimizuar parregullsi të përdoruesve dhe nevojën për suport.</p>
4	<p>Nga auditimi u konstatua se RASH nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve, problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT. Në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti dhe mbështetja teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve. Institucioni nuk disponon procedura për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi për kryerjen e ndryshimeve.</p>	faqe 34-41	e lartë	<p>Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Rrjetin Akademik Shqiptar të marrin masa për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve, problemeve si dhe menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.</p>

I.3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit

Grupi i auditimit mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH” datë 27.11.2014 konstaton se, Rrjeti Akademik Shqiptar është i vetmi institucion në vend që ka zhvilluar dhe ndërtuar disa sisteme informatike me programues të cilët janë punonjës të institucionit, duke ofruar zgjidhje në informatizimin e proceseve të administrimit të brendshëm dhe akademik të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe informatizime të rëndësishme për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Për Rrjetin Akademik Shqiptar nuk është financuar asnjë e ardhur nga buxheti i shtetit apo buxhetet e universiteteve, me qëllim mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemeve informatike që ka ndërtuar dhe ofron për Institucionet e Arsimit të Lartë dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Nga Ministria e Arsimit dhe Institucionet e Arsimit të Lartë Publik, megjithëse si institucione themeluese të RASH, nuk është zbatuar pika 5/c e VKM nr.88, datë 14.02.2018, në të cilën ato përcaktohen si burime të financimit të Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar, duke vendosur institucionin në kushtet e riskut të ekzistencës së tij dhe të zhvillimeve e produkteve informatike të rëndësishme që ka ofruar deri tani.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH” si dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 74/1, datë 06.02.2023 të miratuar nga Kryetari i KLSH-s, me afat auditimi 06.02.2023 deri në 07.04.2023, në RASH, ku periudha e audituar është 01.01.2020 deri në 30.12.2022, u krye auditimi me objekt “*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*”, nga audituesit:

1. E. C, përgjegjëse grupi;
2. A. K, anëtare.

II.1 Objekti i auditimit

Objekti i Auditimit TIK është përcaktimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrën e duhur duke përdorur burimet IT, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

II.2 Qëllimi i auditimit

Qëllimi i Auditimit TIK është vlerësimi nëse se ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve TIK dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë.

Për të arritur në dhënien e një opinioni, janë mbledhur informacione, të dhëna dhe prova, për të përcaktuar nëse nëpërmjet sistemeve të teknologjisë së informacionit mbrohen asetet, ruhet integriteti i të dhënave, si dhe synimet e subjektit që auditohet arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet në mënyrë efikente.

II.3 Identifikimi i çështjeve

Drejtimit e këtij auditimi janë bazuar në programin protokolluar me nr. 74/1, datë 06.02.2023:

1. Auditimi i programeve “Software” që ofrojnë shërbime, për arsimin e lartë dhe parauniversitar, agjencitë e varësisë si dhe kërkimit shkencor dhe inovacionit.
2. Siguria, ruajtja e informacionit si dhe ndërveprimi për bazat e të dhënave që janë krijuar apo administrohen nga RASH.

II.4 Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Bazuar në marrëveshjen Ndërqeveritare Italo-Shqiptare të ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar dhe funksionale prej vitit 2010 për krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar, në 14 shkurt 2018 u riorganizua me anë të një marrëveshje nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe rektorëve të 12 universiteteve publike shqiptare, Qendra e përbashkët Ndërinstitucionale për Rrjetin Telematik - RASH, për kërkimin dhe zhvillimin me fokus Teknologjinë e informacionit dhe Telekomunikacionit.

Baza ligjore ku mbështetet RASH është:

- Ligji nr. 9704, datë 02.04.2007 Për Ratifikimin e “Marrëveshjes Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për Realizimin e një Qendre Shërbimesh dhe të një Rrjeti Telematik për Universitetet”;
- VKM nr. 88, datë 14.02.2018, “Për krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH)”.

Elementët kryesorë të strategjisë së institucionit, janë:

- Zhvillimi dhe ofrimi i platformave software, për administrimin e procesit të aplikimit për pranimet në studime universitare, administrimin e proceseve akademiko-shkencore si dhe administrative në universitet, formimin dhe testimin on-line për arsimin e lartë.
- Ruajtja e informacionit (back up/storage) për bazat e të dhënave që krijon ose administron për universitetet, ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe agjencitë e varësisë për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor apo palë të treta si dhe ndërveprimi i këtyre bazave të të dhënave;
- Mbledhja, përpunimi dhe publikimi i të dhënave për arsimin dhe kërkimin shkencor, për llogari të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si një burim i të dhënave, i statistikave dhe i analizave;
- Zhvillimi dhe zgjerimi rrjetit Telematik kombëtar për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, duke i garantuar komunitetit arsimor, akademik dhe kërkimor shqiptar lidhjen ndërqytetëse, ndërkufitare, lidhjen me rrjetin evropian të arsimit dhe kërkimit GÉANT e ofrimin e shërbimeve të këtij rrjeti në Shqipëri, si dhe lidhjen me rrjetet botërore të arsimit dhe kërkimit;
- Zhvillimi dhe ofrimi i infrastrukturës për Cloud computing dhe Supercomputing nëpërmjet Qendrës së të Dhënave për Arsimin dhe Shkencën (Datacenter) dhe çdo infrastrukture tjetër TIK të nevojshme për IAL-të dhe institucionet pjesëmarrëse.

II.5 Përgjegjësitë e audituesve

Auditimi në RASH, si pjesë e planifikimit vjetor të institucioneve audituar nga KLSH, mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2020 deri në 30.12.2022, u fokusua në sistemet e teknologjisë së informacionit që institucioni ka ndërtuar, mirëmban dhe ju ofron Institucioneve të Arsimit të Lartë - IAL dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë - MASR si qendër e përbashkët ndërinstitucionale për kërkim – zhvillim, me fokus Teknologjinë e informacionit dhe Telekomunikacionit.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban programi i auditimit nr. 74/1, datë 06.02.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-s. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, legjisllacionin në të cilën bazohet aktiviteti i RASH si dhe standardet e auditimit. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese është siguruar një evidencë e përshtatshme e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

II.6 Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165);
- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 9704, datë 02.04.2007 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e një qendre shërbimesh dhe të një rrjeti Telematik për universitetet”;
- VKM nr. 88, datë 14.02.2018 “Për krijimin e qendrës ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH)”;
- Aktmarrëveshje “Për krijimin e qendrës ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar”;
- Rregulloret përkatëse të funksionimit të institucionit;
- Udhëzime të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë – MASR.
- Standardet TIK, etj.

II.7 Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testimet dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, etj.

II.8 Metodatat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur, janë si më poshtë:

- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullativë të institucionit;
- Intervista zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës;
- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi;
- Verifikime të sistemit si përdorues;
- Ndjekje të proceseve të informatizuara, etj.

II.9 Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH-s si dhe në manualin aktiv të auditimit të Teknologjisë së Informacionit në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me testimet e kryera në sistemet informatike;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, e riorganizuar me marrëveshjen e 12 universiteteve publike shqiptare dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe pikës 3 të VKM-s nr. 88 datë 14.02.2018, ka si qëllim:

- a) zhvillimi dhe promovimi i projekteve të kërkim-zhvillimit dhe inovacionit në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) për arsimin dhe shkencën;
- b) krijimi i infrastrukturës për ngritjen e një qendre të përbashkët ndërdisiplinore kërkim zhvillimit (TIK) nga IAL-të pjesëmarrëse apo palë të treta;
- c) koordinimi i pjesëmarrjes së kërkuesve vendës në projektin evropian të kërkimit GÉANT dhe projekte të tjera në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), pjesë përbërëse e programit kuadër evropian të kërkim zhvillimit dhe inovacionit;
- ç) zhvillimi i programeve software dhe ofrimi i shërbimeve përkatëse për ministrinë përgjegjëse për arsimin, agjencitë e varësisë për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, institucionet e arsimit të lartë, të kërkimit shkencor dhe inovacionit e për të gjithë anëtarësinë e RASH-it, si dhe për palë të treta.

Zhvillimi historik që institucioni ka patur prej vitit 2007 e deri më sot, është si më poshtë:

2007	Parlamenti Shqiptar ratifikon marrëveshjen ndërqeveritare Shqiptaro-Italiane, për themelimin e Rrjetit Akademik Shqiptar me Ligjin nr. 9704 dt.7/4/2007
2009	VKM nr. 236 dt.6/3/2009, “Për krijimin e Qendrës Ndëruniversitare të Shërbimeve dhe Rrjetit Telematik”.
2011	Nënshkrimi i kontratës së konsulencës me Konsorciumin Universitar Italian CINECA për ndërtimin e QNSHRRT që njihet dhe si “RASH”.
2012	Pilotimi i platformës së përbashkët universitare të sekretarisë online ESSE3
2012	Votimi nga Asambleja e Përgjithshme e TERENA (sot GEANT) i RASH si anëtar me të drejta të plota i Shoqatës Europiane, National Research and Education Networks – NREN.
2016	Fillimi i shërbimeve të rrjetit akademik kombëtar në fibër optike dhe lidhja e tij me rrjetin European të Shkencës dhe Arsimit GEANT.
2016	Fillimi i shërbimit të parë kombëtar software për arsimin nga RASH nëpërmjet platformës për aplikimin në universitete i quajtur “U-ALBANIA”.
2016	Komisioni European – KE, pranon aplikimin e RASH për pjesëmarrjen në projektin GN.4-2 të financuar nga Horizon2020.
2017	Në nëntor u firmos marrëveshja me 12 Rektorët e universiteteve publike dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për riorganizimin e RASH në një Qendër të përbashkët ndërinstitucionale për kërkim-zhvillim në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Telekomunikacionit.
2018	VKM nr.88 datë 14.02.2018 “Për riorganizimin e RASH nisur nga një iniciativë e 12 universiteteve publike shqiptare dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) për të krijuar një Qendër të përbashkët ndërinstitucionale”.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë Publik - IAL, kanë nënshkruar një Aktmarrëveshje për marrjen e shërbimeve nga RASH, në fund të vitit 2017. Në mbështetje të kësaj marrëveshje është miratuar VKM nr.88, datë 14.02.2018 “Për krijimin e qendrës ndërinstitucionale të rrjetit akademik shqiptar (RASH)”.

Fig.1: Asambleja e Anëtarësisë së Rrjetit Akademik Shqiptar



RASH ka zhvilluar (in house) dhe mirëmban me punonjësit e vetë institucionit, disa sisteme informatike në zbatim të pikës 4 të VKM nr. 88 datë 14.02.2018 “Për krijimin e qendrës ndërinstitucionale të rrjetit akademik shqiptar”, ku citohet se:

Për realizimin e qëllimit të saj, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar kryen veprimtaritë e mëposhtme:

a) *Zhvillimin dhe ofrimin e sistemeve më të përparuara software për administrimin e procesit të aplikimit universitar, menaxhimin e proceseve akademiko-shkencore dhe administrative-universitare dhe platformave për formimin dhe testimit on-line për arsimin e lartë, në kuadër të rritjes së cilësisë në arsim dhe pjesëmarrjes në aktivitetet e kërkimit dhe të zhvillimit, të drejtuara nga komuniteti shkencor dhe arsimor ndërkombëtar;*

b) *Marrjen e masave të nevojshme të sigurisë dhe të ruajtjes së informacionit (back up) për bazat e të dhënave që krijon ose administron për llogari të IAL-ve pjesëmarrëse, ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe agjencive të varësisë për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor apo palëve të treta dhe ndërveprimi i këtyre bazave të të dhënave për të gjithë anëtarësinë e RASH-it;*

c) *Mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave për arsimin dhe kërkimin shkencor, për llogari të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si një burim i të dhënave, i statistikave dhe i analizave;*

ç) *Zhvillimin dhe zgjerimin e rrjetit telematik kombëtar për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, duke i garantuar komunitetit arsimor, akademik dhe kërkimor shqiptar lidhjen ndërqytetëse, ndërkufitare, lidhjen me rrjetin evropian të arsimit dhe kërkimit GÉANT e ofrimin e shërbimeve të këtij rrjeti në Shqipëri, si dhe lidhjen me rrjetet botërore të arsimit dhe kërkimit;*

- d) Zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve të infrastrukturës Cloud computing dhe Supercomputing nëpërmjet Qendrës së të Dhënave për Arsimin dhe Shkencën (Datacenter) dhe çdo infrastrukture tjetër TIK të nevojshme për IAL-të dhe institucionet pjesëmarrëse;
- dh) Promovimin e mobilitetit të maturantëve dhe studentëve përmes shkëmbimit të të dhënave të tyre elektronike, pjesë e rrjetit ndërkombëtar të “Deklaratës së Gronigenit”;
- e) Pjesëmarrjen në rrjetin evropian të sistemeve informatike universitare EUNIS, në shërbim të zgjerimit të spektrit të shërbimeve TIK për anëtarësinë;
- ë) Organizimin e veprimtarive mësimore dhe trajnuese që finalizohen me lëshimin e certifikatës përkatëse.

Për sistemet informatike të ndërtuara nga RASH, nuk janë shpenzuar fonde nga buxheti i shtetit apo buxheti i universiteteve.

Sistemet informatike ofruar për Institucionet e Arsimit të Lartë janë:

Pitagora. Sistemi i sekretarisë online, i cili ofron funksionalitete për sekretarinë dhe aktorë të tjerë si studentët apo pedagogët;

UFinanca. Portali për Menaxhim financiar dhe Kontabilitetin, zhvilluar në vitin 2020 nga RASH, për universitetet publike shqiptare;

Ucris. Platforma e universitetit për katalogimin e punimeve shkencore të stafit akademik;

Vuni. Platforma e universitetit virtual e-learning, përdorur nga disa universitete në periudhë e pandemisë për një periudhë sezonale.

Sistemet informatike ofruar për MASR janë:

Ualbania. Portali i aplikimit universitar, në të cilin maturantët aplikojnë dhe regjistrohen në programe studimi;

Mësues për Shqipërinë. Me kërkesë të Ministrisë së Arsimit, ky sistem është në përdorim prej disa vitesh, i konceptuar, ndërtuar dhe mirëmbahet nga RASH.

Portali i Trajnimeve. Konceptuar në vitin 2021 dhe i bazuar në udhëzimin nr.16, datë 28.07.2021 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën nr.4186/1 prot, datë 28.07.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.

Institucionet e Arsimit të Lartë Publik, megjithëse janë institucione bashkë themeluese të RASH dhe kanë detyrim zbatimin e VKM nr. 88 datë 14.02.2018 “Për krijimin e qendrës ndërinstitucionale të rrjetit akademik shqiptar”, kanë zhvilluar sisteme informatike duke u informatizuar pjesërisht, megjithëse janë ofruar nga RASH. Ky konstatim mbështet të faktin që KLSH ka audituar sistemet e teknologjisë së informacionit në vitin 2022 në tre universitete, raportet e të cilëve janë publikuar në fazën zyrtare të institucionit:

- Universitetin e Tiranës, linku <https://panel.klsh.org.al/storage/phpPD8cP9.pdf> ;
- Universitetin e Vlorës, linku <https://panel.klsh.org.al/storage/phpV8t7Df.pdf> ;
- Universitetin e Shkodrës, linku <https://panel.klsh.org.al/storage/phpfozt6s.pdf> .

Nga auditimi u konstatua se Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe IAL-të, e kanë vendosur Rrjetin Akademik Shqiptar në kushtet e riskut të ekzistencës së tij, pasi nuk kanë financuar për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemeve informatike që j’u ka ofruar, në kundërshtim me VKM nr.88, datë 14.02.2018, në pikën 5 ku citohet se:

“Burimet e financimit të Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar janë:

c. kontributi vjetor i anëtarësisë nga IAL-të dhe institucionet e tjera;

ç. kontributi vjetor i ministrisë përgjegjëse për arsimin, i agjencive dhe IAL-ve, sipas shërbimeve përkatëse të ofruara”.

2. Përshkrim i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Auditimi i programeve “Software” që ofrojnë shërbime, për arsimin e lartë dhe parauniversitar, agjencitë e varësisë si dhe kërkimit shkencor dhe inovacionit.

I. Sistemet e ndërtuara nga RASH për Institucionet e Arsimit të Lartë – IAL.

Pitagora. Është sistemi i sekretarisë online, i cili ofron funksionalitete për sekretarinë dhe aktorë të tjerë si studentët apo pedagogët. Modulet kryesore të këtij sistemi janë:

- Hapja e vitit akademik;
- Pasqyrimi i planeve mësimore;
- Krijimi i orarit mësimor dhe regjistrimi i studentëve në orar nga faqja e tyre;
- Publikimi i rezultateve të provimit online nga faqja e pedagogut;
- Gjenerimi i procesverbaleve;
- Pasqyrimi në librezën elektronike të studentit;
- Regjistrimi i studentëve në riprovime nga faqja e tyre;
- Moduli i financës, finalizimi i karrierës studentore;
- Kalueshmëria e studentëve nga njëri vit në tjetrin në bazë të kriterëve të kalueshmërisë.
- Në sistemin Pitagora bëhet regjistrim manual për kategoritë: studentë të transferuar dhe studentë nga trojet.

Nga auditimi u konstatua se ky sistem është i parametrizueshëm sipas kërkesës dhe si i tillë ai përmbush nevojat e IAL-ve. Gjithashtu, RASH disponon kapacitete njerëzore, me njohuri të konsiderueshme në kodim, për të përmbushur kërkesa të veçanta të universiteteve, në lidhje me përdorimin e sistemit Pitagora.

Gjatë auditimit në terren janë konstatuar disa mangësi që nuk pengojnë funksionimin e sistemit, por i shërbejnë përmirësimit të tij.

Nga auditimi mbi strukturën e ngritur të këtij sistemi është konstatuar se:

- Janë hartuar akte rregullative mbi përdorimin e tij në varësi të rregulloreve të çdo universiteti që merr shërbimet e ofruara nëpërmjet sistemit Pitagora;
- Nuk janë hartuar diagrame të qarkullimit të informacionit, dokumente që njihen ndryshe si Workflow;
- Përdoruesve me kërkesë të tyre ju është dhënë aksesimi për fshirje të të dhënave nga ndërfaqja. Nga kjo e drejtë që ata kanë kërkuar, krijohen disa problematika të cilat i adresohen për zgjidhje RASH-it, duke rritur nevojën për suport të shpeshtë në rikthimin e të dhënave.

Nga auditimi mbi çështjet e raportuara si problematika lidhur me përdorimin e këtij sistemi u konstatua se universiteti i cili ka më pak raportime është universiteti i Korçës, i cili rezulton të jetë dhe i vetmi Universitet që nuk ka kërkuar të drejta për fshirjen e të dhënave në çdo nivel përdoruesi. Kjo tregon se dhënia e aksesit për fshirje, ka rritur numrin e problematikave të raportuara.

Universitetet që punojnë me sistemin “Pitagora”, si dhe numri i përdoruesve, për secilin prej tyre paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1: Përdoruesit e sistemit Pitagora

Universitetet	Studente aktiv			Staf Akademik	Staf Administrativ
	2019/2020	2020/2021	2021/2022		
Universiteti i Sporteve	1,426	1,475	1,523	169	11
Universiteti i Arteve	985	1,025	1,007	491	7

Universiteti Bujqësor	6,802	6,472	5,702	401	15
Universiteti i Mjekësisë	4,048	4,661	5,140	881	16
Universiteti i Fan Noli	3,744	3,187	3,068	359	10
Universiteti i Eqrem Cabej	785	1,318	730	236	10
Universiteti i Luigj Gurakuqi	5,727	5,255	4,574	648	19
Universiteti Aleksandër Moisiu	6,139	8,017	7,769	1,188	93

Burimi i të dhënave: RASH

Programi Pitagora është konceptuar dhe ndërtuar në mënyrë të tillë që kurrikula të lëvizet nga një program në një tjetër e gjithashtu t'i ndryshohet emri nëse është e nevojshme. Kjo do të thotë se veprimet e fshirjes nuk ka asnjë arsye të kryhen në sistem nga përdoruesit fundor që marrin këtë shërbim të cilët janë punonjës të universiteteve.

Nga auditimi u konstatua se modifikimi i kurrikulës rezulton të jetë dhe problemi më shpesh i raportuar dhe më me impakt tek të gjithë përdoruesit në lidhje me përdorimin e sistemit "Pitagora". Modifikimi apo shtimi i kurrikulës bëhet në modulin "Programe" ku sipas ciklit dhe brezit mund të zgjidhet programi i studimit.

Fig.2: Ndërfaqja e sistemit në të cilën modifikohet Kurrikula

Burimi i të dhënave: Sistemi Pitagora

Veprimi i fshirjes së Kurrikulës, në rastin kur është populluar me të dhënat e studentit, shoqërohet dhe me fshirjen e të dhënave të studentit/studentëve për këtë kurrikul.

Për çdo veprim ruhen gjurmët elektronike të auditimit dhe investigimi mbi përdoruesit që kanë kryer këto veprime është i identifikueshëm.

Nga auditimi mbi krijimin, plotësimin si dhe fshirjen e kurrikulës u konstatua se:

- Gjatë plotësimit të të dhënave në fushën "Mënyra e vlerësimit" është vendosur si një nga mënyrat dhe opsioni "Mbrojtje Anglishteje", në vend të mbrojtje gjuhë e huaj duke qenë se MAS ka një listë gjuhësh të miratuara si të detyrueshme për programet studimore për tipin "Master".
- Në krijimin e një kurrikule nuk përcaktohet tipi i saj nëse është "Provim" apo "Firmë".
- Nuk shfaqet mesazh gabimi në rast se veprohet nga përdoruesi për ndryshimin e kodit të lëndës në modulin "Lëndët", megjithëse nuk ruhen ndryshimet kur kodi ekziston dhe i përket një lënde tjetër.

- Fshirja e kurrikulës ndodh pasi në Pitagora me lejimin e fshirjes, nuk është bërë një ndarje e këtij veprimi sipas popullimit, në mënyrë që:

1. Fshirja e kurrikulës kur ajo sapo është krijuar, pra në kushtet kur të dhënat e studentit nuk janë populluar;
2. Fshirja e kurrikulës kur ajo është vendosur në programin e gabuar, por ka dhe të dhënat e studentit.

Në modulën “*Studentët/Regjistrimi manual i studentëve*” kryhen regjistrime për studentët që vijnë nga trojet si dhe ata që transferohen. Të dhënat për studentët brenda vendit janë të populluara nga sistemi “*Ualbania*”, por në këtë modul mund të bëhen modifikime mbi të gjitha fushat përveç programit të studimit.

Fig.3: Ndërfaqja e sistemit në të cilën hidhen të dhëna në regjistrimin e studentit

Emri *	Atësia *	Mbiemri *	Numri personal *
Nr. matrikullimit *	Email *	Email Universiteti	Telefoni *
Data e regjistrimit *	Datëlindja *	Gjendja Civile *	Gjinia *
Shkolla e mesme *	Adresa *	Vendlindja *	Shtetësia *
Programi *	Gjendja e studentit *	Numri i Diplomës	Numri Serial i Diplomës
Tema e diplomës	Numri i studentit nga regjistri themeltar	Numri rendor i regjistrimit të diplomes	
Tipologji Programi *	Degë e parë studimi	ID Universiteti	
Mesatarja e studimeve universitare	Mesatarja e shkolles se mesme VKM	Mesatarja e shkolles se mesme M1	Mesatarja e shkolles se mesme M2
Konfirmo Dokumentacionin	Instituti i mëparshëm	Viti i maturës	ID e maturës
Rrethi	Komuna	Tipi i diplomës së parë	Data e lëshimit të diplomës
ID diploma e parë	<input type="checkbox"/> I transferuar	Universiteti nga ku është transferuar	<input type="checkbox"/> I huaj
Shënime			

Burimi i të dhënave: Sistemi Pitagora

Nga auditimi mbi modulën “Studentët/Regjistrimi manual i studentëve”, u konstatua se:

- Në modifikimet e të dhënave për studentët e importuar lejohen të bëhen modifikime në të gjitha fushat përveç programit. Fushat, ku mund të jetë i nevojshëm modifikimi janë: mbiemri, numri i matrikullimit, e-mail, telefon, vendbanimi, gjendja civile.

- Fushat, të dhënat e të cilave zgjidhen nga një listë si “Programi” dhe “Gjendja e Studentit”, nuk janë të renditura sipas rendit alfabetik.
- Me zgjedhjen e gjendjes së studentit në fushën “Gjendja e Studentit”, nuk janë përcaktuar fushat tek të cilat mund të kryhen modifikime ose plotësime.
- Me zgjedhjen e opsionit “I transferuar” e cila tregon se studenti ka transferuar studimet nga një program në një tjetër, fusha që nevojitet të plotësohet është “Universiteti nga është transferuar” e cila nuk është e tipit listë, duke mundësuar që të dhënat të mos shkruhen në forma të ndryshme kur nevojitet të themi të njëjtin emërtim.
- Në listën e të dhënave të fushës “Gjendja e Studentit” janë vendosur disa emërtime në Italisht, kur gjuha e ndjekur në aplikacion është gjuha shqipe.
- Në fushën “Datëlindja”, ku plotësohet data e lindjes së studentit, nuk janë implementuar mesazhe informuese për përdoruesit në rastet e pasaktësisë në plotësimin e saj si shembull: data nuk është plotësuar në formatin e kërkuar, ose data e lindjes nuk mund të jetë më pak se 18 vite.
- Nuk janë implementuar kontrole kufizuese mbi karaktere speciale në fushat Emër, Atësi, Mbiemër. Plotësimi i këtyre të dhënave nuk mund të përmbajë karaktere speciale.
- Fushat “Shkolla e Mesme”, “Vendlindja” dhe “Shtetësia” nuk janë në formën listë, çfarë mundëson që të dhënat të mos shkruhen në forma të ndryshme për të njëjtin emërtim.
- Në të gjitha fushat që mund të modifikohen, mund të plotësohen me operatorët logjikë OR dhe AND.
- NID është një e dhënë e konceptuar si unike e cila nuk mund të ndryshohet pasi ka përfunduar regjistrimi i studentit, por kjo e dhënë është kërkuar të modifikohet nga disa universitete në rastet kur është regjistruar gabim apo është importuar nga të dhëna të sistemit të mëparshëm. Nga auditimi u konstatua se nuk janë shtuar kontrole paralajmëruese përpara ruajtjes së regjistrimit të studentit për të dhënë e NID si e dhënë e pandryshueshme, çfarë ndihmon përdoruesin të kontrollojë të dhënat e regjistruara.

Në modulën *Krijo Orar/ Orari Mësimor* vendosen të dhëna mbi datat e provimeve dhe regjistrohen studentët për provimet nga vetë ata, sekretaria apo automatikisht nëpërmjet sistemit.

Fig.4: Ndërfaqja e sistemit në të cilën krijohet apo regjistrohet Orari

Burimi i të dhënave: Sistemi Pitagora

Nga auditimi mbi modulën Krijo Orar/ Orari Mësimor/ Orari jo periodik, u konstatua se:

- Në opsionin e krijimit të orarit të provimeve, nuk janë implementuar kontrolle parandaluese mbi formatin e datës së provimit.
- Të dhënat që zgjidhen nga një listë si “Pedagogu”, nuk janë renditur sipas rendit alfabetik.
- Tek orari periodik mund të plotësohen të dhëna mbi orarin mësimor, por aktualisht është një funksionalitet që nuk është vënë në përdorim nga universitetet.

Në modulën Krijo Orar/ Orari Mësimor/ Orari për përsëritës, studentët mund të regjistrohen vetë për përsëritjen e provimeve. Nga auditimi mbi këtë modul, u konstatua se:

- Të dhënat që zgjidhen nga një listë si Pedagogu, nuk janë renditur sipas rendit alfabetik. Në opsionin e krijimit të orarit të provimeve, nuk janë implementuar kontrolle parandaluese mbi formatin e datës së provimit.

Nga auditimi mbi fjalëkalimin e përdoruesve, kur krijohet një llogari përdoruesi e re dhe pajiset me fjalëkalimin fillestar, u konstatua se sistemi nuk e ka të detyrueshme në logim-in e radhës ndryshimin e fjalëkalimit përpara çdo veprimi, megjithëse është vendosur një kontroll informues mbi çdo modul me të cilin përdoruesi vepron.

Fig.5: Ndërfaqja e sistemit në modulën Pedagogët

Emri * Adela	Mbiemri * Haxhiraj	Atësia * Zef
Numri personal	Email * adela.haxhiraj@umed.edu.al	Telefoni * 0693021522
Titulli akademik * MSC	Data lindja 01/01/1970	Gjinia Femër
Gjendja Civile Beqar/e	Adresa Tiranë	Vendlindja Tiranë
Shtetësia Shqiptare	Data e regjistrimit * 21/06/2022	Data e përfundimit * 20/07/2035
Departamenti * DEPFHMT	Statusi I brendshëm	<input checked="" type="checkbox"/> Ka dorëzuar dokumenta?
Anullo		Modifiko

Burimi i të dhënave: Sistemi Pitagora

Nga auditimi mbi modulën “Pedagogët” ku regjistrohen të dhëna mbi pedagogët e universitetit, por mund të bëhen dhe modifikime mbi të dhënat ekzistuese, u konstatua se:

- Në të plotësohen të dhëna mbi pedagogun dhe titullin akademik si: master i shkencave, Doktor, Profesor i Asociuar dhe Profesor.

Nga auditimi i zhvilluar nga KLSH në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, me programin e auditimit nr.468/3, datë 27.05.2022, u raportua se Në sistemin Pitagora:

- Nuk plotësohen të dhëna kur pedagogu ka marrë titullin, institucionin dhe vitin e diplomimit etj. Këto të dhëna nuk rezultojnë se janë kërkuar të zhvillohen tek RASH
- Nuk ka fusha ku mund të plotësohen të dhëna si: leksione, seminare, laboratorë, praktika për javë mësimi të ndara sipas semestrave.
- Nuk ka raporte mbi totalin e leksioneve, totalin e seminareve, totalin e laboratorëve, totalin e praktikave për javë mësimi si dhe për vit akademik, Orët jashtë orarit, Përqindja e krediteve sipas tipit të veprimtarisë (A,B,C,D,E,F);
- Nuk gjenerohet në PDF plani mësimor.

Nga auditimi mbi Programet, u konstatua se është e mundur plotësimi i të dhënave për leksione, seminare, laboratorë, praktika për javë mësimi të ndara sipas semestrave. Gjithashtu, raporti “Kurrikula” jep të dhëna të detajuara mbi programet, lëndët dhe kreditet, vitet, semestër, me detyrim apo zgjedhje etj.

Tek regjistrimi i elementëve mësimor në modulin “Programet” lista e elementëve është me shkurtime dhe jo emërtime të plota si: Leksion, Seminar, Praktikë, Ushtrime, Laboratorë, etj. Nga auditimi u konstatua se Universiteti i Shkodrës nuk ka kërkuar raporte mbi të dhëna të ndryshme si: plani mësimor, totalin e leksioneve, totalin e seminareve, totalin e laboratorëve, totalin e praktikave për javë mësimi si dhe për vit akademik, Orët jashtë orarit etj.

Fig.6: Ndërfaqja e sistemit për programet

Kurrikula - Bachelor Shëndet Publik (BA)

Kodi: SHP-A
Emri: Shëndet Publik (BA)
Viti: 2022
Lloji i programit: Bachelor
Kodi i profilit: SHP-A
Profili: Shëndet Publik (BA)
Departamenti: DEPFM

Kreditet e kurrikulave me detyrim:
Viti 1: 60, Viti 2: 60, Viti 3: 54, Total: 174

Kreditet e kurrikulave me zgjedhje:
Viti 3: 12, Total: 12

[+ Shto](#)

#	Lënda	Moduli	Kategoria	Kredite	Me detyrim	Viti	Semestri	Parakusht	Elemente	Modifiko	Fshi
1	SHP-A101 - Hyje në SHP		A	11	Detyrim	1	Vjetore		+		
2	SHP-A102 - Biologji		C	3	Detyrim	1	Semestri II		+		
3	SHP-A103 - Gjuhë e Huaj		D	3	Detyrim	1	Semestri I		+		
4	SHP-A104A - Biostatistikë 1		B	6	Detyrim	1	Vjetore		+		

Programi - Bachelor Shëndet Publik (BA)

Elementët Mësimor

Kurrikula - Biostatistikë 1

Element	Orë totale	Kredite	Modifiko	Fshi
Leksion	60.00	6.00		
Seminar	20.00	2.00		

Burimi i të dhënave: Sistemi Pitagora

Nga auditimi mbi raportet e ndërtuara në sistemin Pitagora, u konstatua se evidencat identifikohen nëpërmjet një kodi dhe emërtimi, por nuk ka një fushë përshkrimi ku të jepen detaje përshkuese mbi të dhënat që gjenerohen nga secili prej tyre, çfarë do lehtësonte ngarkesën e sistemit dhe informim paraprak për përdoruesin.

Secili prej përdoruesve i gjeneron raportet në sistem në çdo kohë dhe i shkarkon ato në formatin excel, nga ku mund të bëhen modifikime sipas nevojës.

Fig.7: Lista e raporteve në Pitagora

Kodi	Emërtimi	Shkarko
PAGESAT	Pagesat	↓
KURRIKULA	Kurrikula	↓
KREDITE	Kredite për vit	↓
SALLAT	Sallat e zena	↓
GRUP	Grupet	↓

Burimi i të dhënave: Sistemi Pitagora

UFINANCA - Portali për Menaxhim Financiar dhe Kontabilitetin. Në vitin 2020 RASH ka zhvilluar platformën financiare për universitetet publike shqiptare. Analiza është bazuar në udhëzimin nr. 8/2018 Ministria e Financës.

Platforma ofron funksionalitetet dhe menaxhon të gjitha komponentët e mëposhtëm:

- Budget: planifikimi i buxhetit;
- Inventarët: Menaxhimi i inventarëve (afatgjatë dhe qarkullues);
- Payroll: Pagat e punonjësve të brendshëm dhe të jashtëm;
- HR: Burimet Njerëzore;
- Taksat, Bursat, Kontratat: kontabilizim i automatizuar i pagesave të studentëve nga thesari ose bankat;
- Projektet: shpenzimet dhe të ardhurat nga projektet;
- Raportet: Shkarkimi i pasqyrave progresive dhe vjetore si dhe raporte të tjera.(libri i madh, ditari, etj.);

Bilanci: Përgatit Bilancin me veprimet e mbylljes në mënyre të automatizuar;

Lidhja e automatizuar me MASR:

- Mundëson transmetimin e raporteve financiare;
- Është planifikuar të lidhet me Agjencinë e financimit AKFAL për financimet (në proces)
- Është planifikuar të lidhet me Agjencinë e kërkimit AKKSHI për aplikimet në projekte (në proces)

Fiskalizimi: Është duke u zhvilluar funksionaliteti për transmetimin e pagesave tek tatimet sipas ligjit të ri.

Nga auditimi mbi këtë sistem u konstatua se:

- Krijimi nga RASH i Platformës Software “UFinance” është bazuar në VKM nr.88 datë 14.02.2018, pika 4 germa a, ku citohet se: “Për realizimin e qëllimit të saj, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar kryen veprimtaritë e mëposhtme: a) Zhvillimin dhe ofrimin e sistemeve më të përparuara software për administrimin e procesit të aplikimit universitar, menaxhimin e proceseve akademiko-shkencore dhe administrative-universitare dhe platformave për formimin dhe testimin on-line për arsimin e lartë, në kuadër të rritjes së cilësisë në arsim dhe pjesëmarrjes në aktivitetet e kërkimit dhe të zhvillimit, të drejtuara nga komuniteti shkencor dhe arsimor ndërkombëtar;”

- Nuk ka asnjë përdorues. Janë zhvilluar prezantime mbi përdorimin në nivele administrative në universitete;

- Nuk janë hartuar Workflow apo Diagramet e qarkullimit të informacionit për proceset e ofruara nëpërmjet këtij sistemi.
- Prezantime për këtë soft janë bërë në IAL publike, por ky sistem nuk është në përdorim nga IAL.

UCRIS. Është platforma e universitetit për katalogimin e punimeve shkencore të stafit akademik si:

- Publikime shkencore, artikuj, libra, patenta, pjesëmarrje në kongrese;
- Aseteve të dedikuara për kërkimin shkencor: laboratorë, pajisje, biblioteka.

Sistemi bazohet në pesë kriteret e vlerësimit: bibliometrik, shkencor, infrastrukturor, njerëzor dhe ai i ndërkombëtarizimit.

Ky sistem është zhvilluar mbështetur në VKM nr. 165, datë 21.03.2018 me objekt “Për metodologjinë e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësisve bazë të institucioneve të arsimit të lartë”.

Për zbatimin e këtij vendimi janë ngarkuar Ministria e Arsimit dhe Sportit, institucionet e arsimit të lartë, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit si dhe Rrjeti Akademik Shqiptar.

VUNI. Platforma e universitetit virtual e-learning. Ky sistem është përdorur nga disa universitete në periudhën e pandemisë për një periudhë sezonale.

Aktualisht ky mjet, për mësimin në distancë nuk përdoret nga universitetet, megjithëse përdorimi i tij është pa pagesë.

II. RASH ka zhvilluar dhe ofron disa sisteme për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

UAlbania. UAlbania është portali i aplikimit universitar, në të cilin maturantët aplikojnë dhe regjistrohen në programe studimi. Funkcionalitetet kryesore të tij janë:

- Shkarkimi i faturës së aplikimit;
- Aplikimi i maturantëve në degët e tyre të preferuara;
- Shkarkimi i listave të aplikantëve;
- Ngarkimi i listave të fituesve;
- Regjistrimi i maturantëve në degën e preferuar fituese;
- Gjenerimi i raporteve.

Kategorizimi si dhe numri i përdoruesve, të cilët kanë bërë të paktën një aplikim për 3 vitet e fundit paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2: Përdoruesit e sistemit “UAlbania”

Përdoruesit	2020	2021	2022
Maturantë	25,570	26,760	25,641
Mbikëqyrës	498	485	487
Administrator Universiteti	53	56	60
Sekretare Fakulteti	232	222	243
Dekan	111	128	125

Burimi i të dhënave: RASH

Nga auditimi u konstatua se për përdoruesit e jashtëm dhe të brendshëm në sistemin Ualbania janë ndërtuar rregullore dhe Workflow / Diagramet e qarkullimit të informacionit, për proceset e ofruara nëpërmjet këtij sistemi.

Nëpërmjet sistemit Ualbania, të gjithë maturantët që aplikojnë për studime brenda vendit në universitete private apo publike, aplikimin kryhet online për përzgjedhjen e programeve.

Maturantet e importuar për vitin akademik 2022-2023 janë 37,783.

Studentët që kanë aplikuar për të njëjtin vit akademik janë 24,579, ndërsa të regjistruar për këtë vit janë 21,888 nxënës.

Nuk ka ndërveprim apo shkëmbim të dhënash në mënyrë automatike me sistemin e gjendjes civile dhe me sistemin e QSHA-s.

Mësues për Shqipërinë. Me kërkesë të Ministrisë së Arsimit, ky sistem informatik është konceptuar, ndërtuar dhe mirëmbahet nga RASH dhe është në përdorim prej disa vitesh. Versioni i ri i portalit “Mësues për Shqipërinë” është në funksion që prej vitit 2018. Në këtë portal çdo vit aplikojnë rreth 6,000 mësues, të cilët mund të zgjedhin preferencat dhe të aplikojnë për vendin e mësuesit. Zyrat vendore të Arsimit Parauniversitar regjistrojnë në vendet e punës rreth 1,500 mësues.

Me ndryshimet në ligjin nr.48/2018, datë 23.07.2018 dhe objekt “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.69/2012 ”Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, janë kryer disa ndryshime të cilat përcaktojnë si platformë online portalin “Mësues për Shqipërinë”, më konkretisht në:

- Neni 1 ku citohet se: “Portali “Mësues për Shqipërinë” është platformë online, ku kandidatët për mësues në sistemin e arsimit parauniversitar regjistrohen për të marrë pjesë në konkurrim për një pozicion të lirë pune. Kjo platformë realizon renditjen e kandidatëve, bën shpalljen e vendeve të lira dhe procesin e pranimit të kandidatëve për mësues në pozicionin e lirë të punës në institucionet e arsimit parauniversitar.”

- Neni 17 ku citohet se: “Në institucionin arsimor publik, përfshirë dhe atë parashkollor, pranimi dhe emërimi i mësuesit në një vend të lirë pune mbështetet në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor. Emërimi i mësuesit bëhet nga drejtori i institucionit arsimor, sipas renditjes në portalin “Mësues për Shqipërinë”. Procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune, si dhe administrimi i portalit “Mësues për Shqipërinë” përcaktohen me udhëzim të ministrit.”

Me udhëzimin e Ministrit të Arsimit nr. 12, datë 10.06.2021 për “Procedurat e pranimit të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë””, RASH në kreun 3 ngarkohet të kryejë disa detyra të cilat janë:

1. RASH-i garanton që portali “Mësues për Shqipërinë” të krijojë llogari për anëtarët e komisionit të Vlerësimit të Dosjeve (KVD) që do të vlerësojnë online dosjet për konkurrim, mundëson hedhjen e pikëve të dosjes së çdo aplikanti duke e lidhur me ID-në e personit, si dhe siguron kalimin e online të pikëve të testimit elektronik nga QSHA-ja në llogarinë personale të aplikantit.

2. RASH -i është përgjegjës për administrimin e softit elektronik të portalit “Mësues për Shqipërinë” dhe të regjistrimit online të kandidatit për të marrë pjesë në konkurrim.

3. Hedhja e rezultateve të kandidatëve nga vlerësimi i dosjeve bëhet nga DRAP-ja në llogaritë e hapura nëpërmjet funksionalitetit në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

4. RASH -i, nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”:

a. Zbaton funksionalitetin që ngarkon rezultatet e testimit të informatizuar që i përcillen zyrtarisht nga QSHA-ja;

- b. Zbaton funksionalitetin që bën renditjen e kandidatëve sipas pikëve totale (shuma e pikëve të dosjes dhe e pikëve të testimit) për kandidatët për çdo ZVAP dhe për çdo profil;
- c. Vë në dispozicion të ZVAP-së funksionalitetin për pranimin ose refuzimin e një vendi pune nga ana e kandidatit.

5. RASH-i garanton që portali “Mësues për Shqipërinë” prodhon aktin e pranimin të vendit të punës.

Në zbatim të udhëzimit të mësipërm nga Ministria e Arsimit dhe Sportit me urdhrin nr. 4, datë 08.04.2022 të drejtorit të përgjithshëm është ngritur grupi i punës me qëllim zbatimin e detyrave që i ngarkohen RASH-it, përfshirë dhe ndryshimet e mëvonshme të tij dhe komunikimet me MASR.

Nga auditimi u konstatua se në këtë sistem janë adresuar kërkesat e MASR, gjithashtu RASH disponon burime njerëzore, me njohuri të konsiderueshme në kodim, për të realizuar kërkesa të veçanta që mund të lindin me përdorimin e këtij sistemi.

Gjatë auditimit në terren grupi i auditimit ka konstatuar disa mangësi, të cilat nuk pengojnë funksionimin e sistemit, por i shërbejnë përmirësimit të tij. Të gjitha konstatimet janë shoqëruar me një pamje rast pas rasti të modulit përkatës, në mënyrë që të jetë më e lehtë referenca e konstatimit.

Nga auditimi janë konstatuar disa nevoja për përmirësime, të cilat renditen më poshtë:

- Nuk janë hartuar diagramet e qarkullimit të informacionit për proceset e ofruara nëpërmjet këtij sistemi të cilat njihen ndryshe si Workflow;
- Në portal vihet në dispozicion një video prezantuese në rolin e një udhëzuesi se si të punohet për plotësimin e të dhënave.

Nga testimet që u kryen mbi sistemin “Mësues për Shqipërinë”, u konstatua se:

- Tek “Regjistrimi”, mësuesi hap llogarinë personale për herë të parë. Për ngarkimin e dosjes është konceptuar një fushë në të cilën bashkëngjitet duke upload-uar dokumentet që mësuesi dorëzon në aplikim. Për t’ju ardhur në ndihmë përdoruesve që në këtë rast janë mësues, është vendosur një tutorial i cili udhëzon në anglisht se si të bëhen “zip” dokumentet për aplikim, gjuhë e cila nuk njihet nga çdo mësues.

Fig.8: Ndërfaqja për ngarkimin e dosjes gjatë hapjes së llogarisë së mësuesit

Burimi i të dhënave: Portali Mësues për Shqipërinë

- Nuk janë implementuar kontrole mbi datën e lindjes së mësuesit që plotësohet në regjistrimin fillestar të tij, që do të thotë se të dhënat e datës së lindjes mund të jenë çfarëdo. Në fushat që plotëson mësuesi për Emrin, Atësinë dhe Mbiemrin nuk janë implementuar kontrole të karaktereve numerike apo speciale, pra këto të dhëna mund të plotësohen duke vendosur karaktere të tipit: ‘,’/] etj.

- Fushat e detyrueshme nuk janë identifikuar me tregues specifik si “*” apo ngjyrë tjetër, e cila i tregon përdoruesit, se nuk mund të vazhdojë më tej pa bërë plotësimet e nevojshme. Për plotësimin e fushave të detyrueshme nuk janë implementuar kontrole me plotësimin e tyre hap

pas hapi. Një kontroll është implementuar në butonin e fundit “regjistrohu”, që shërben për ruajtjen e aplikimit.

- Numri personal me numrin e pasaportës janë konceptuar në të njëjtën fushë, por këto dy numra nuk kanë të njëjtin format. Nisur nga kjo nuk implementohet dot kushte parandaluese në hedhjen e të dhënave të sakta për formatin e NID-it dhe numrit të pasaportës. Në rast se këto fusha do të ishin të ndara ku të plotësohet të paktën njëra prej tyre, është lehtësisht e mundur vendosja e kushteve mbi formatin që duhet të kenë në gjatësi karakteresh dhe në përmbajtje. Nuk është vendosur një maskë orientuese për numrin që nevojitet të plotësohet nga përdoruesi si në rastin e datëlindjes.

Fig.9: Ndërfaqja për hapjen e llogarisë së mësuesit

Krijo profilin

Emri

Atesia

Mbiemri

Nr Personal/Nr Pashaportes

Datelindja

Gjinia MASHKULL FEMER

Email

Vendbanimi Prane ZVAP

Numri i Telefonit

Ngarko dosjen(vetem zip/rar/7zip) Max 50Mb Tutorial No file selected.

Kujdes! Dosja duhet te permbaje te pakten 5 dok te detyrueshem sipas shtojces 1 te udhezimit.Pasi te keni aplikuar kontrolloni qe dosja te jete ngarkuar korrektesisht.

Punesimi Aktual

ZVAP I PUNESIMIT(nese ka)

Burimi i të dhënave: Portali Mësues për Shqipërinë

Të dhëna që nuk mund të ndryshohen nga llogaria e mësuesit janë: email dhe Nr Personal/Nr Pasaportës.

Me përfundimin e afatit të aplikimit, administratori i sistemit mbyll të drejtën e aplikimeve, apo ndryshimeve për aplikantët duke qenë se dosjet kalojnë në një fazë tjetër që është vlerësimi i tyre.

Në vlerësimin e dosjeve të aplikantëve nga DRAP – Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, shkarkon dokumentet të cilat pas shqyrtimit, veprohet në sistem nga vlerësuesi nëse pranohet apo refuzohet. Me zgjedhjen e opsionit “Konfirmo s ‘kualifikimin / përjashtimin e kandidatit”, nuk ka një fushë të detyruar ku të jepen arsyet e refuzimit, të dhëna të nevojshme për DPAP- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.

Fig.10: Ndërfaqja për vlerësimin e mësuesit

Nr	ID	Aplikanti	Emër	Mbiemër	Profili	ZA	Vendorezim	Dosja	Skualifikim/Perjashtim	Vleresim Dosjes	Piket test mbartura	Piket e dosjes	Piket e testimit	Piket totale	Konfirmo Piket e Dosjes	Shënim
1					Arsimi Parashkollor	Fier	Fier		Kualifikuar Ndrysho	Nuk Mbarten Vendos	Nuk Mbarten	?	?	?	Jo Konfirmuar Konfirmo	Shëno
2					Arsimi Parashkollor	Fier	Fier		Kualifikuar Ndrysho	Nuk Mbarten Vendos	Nuk Mbarten	?	?	?	Jo Konfirmuar Konfirmo	Shëno
3					Arsimi Parashkollor	Fier	Fier		Kualifikuar Ndrysho	Nuk Mbarten Vendos	Nuk Mbarten	?	?	?	Jo Konfirmuar Konfirmo	Shëno
4					Arsimi Parashkollor	Fier	Fier		Kualifikuar Ndrysho	Nuk Mbarten Vendos	Nuk Mbarten	?	?	?	Jo Konfirmuar Konfirmo	Shëno
5					Arsimi Parashkollor	Fier	Fier		Kualifikuar Ndrysho	Nuk Mbarten Vendos	Nuk Mbarten	?	?	?	Jo Konfirmuar Konfirmo	Shëno
6					Arsimi Parashkollor	Fier	Fier		Kualifikuar Ndrysho	Nuk Mbarten Vendos	Nuk Mbarten	?	?	?	Jo Konfirmuar Konfirmo	Shëno
7	15177	J85702029G	ANXHELA	ZAIMI	Arsimi Parashkollor	Fier	Fier		Kualifikuar Ndrysho	Nuk Mbarten Vendos	Nuk Mbarten	?	?	?	Jo Konfirmuar Konfirmo	Shëno


Burimi i të dhënave: Portali Mësues për Shqipërinë

Fusha “Shënim” është e njëjta fushë ku mund të shkruajnë apo ndryshojnë të gjitha nivelet e përdoruesve: DRAP – Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, DPAP- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe ZVAP- Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar. Pra, në këtë fushë shënimi i kryer nga DRAP mund të ndryshohet nga DPAP apo ZVAP dhe anasjelltas, çfarë pengon shënimet të mbeten si rekorde për efekt kontrolli apo gjurme në secilën nga fazat e vlerësimit.

Fig.11: Ndërfaqja e sistemit ku vendosen shënime nga DAR, ZVAP.

Burimi i të dhënave: Portali Mësues për Shqipërinë

Në adresën: <https://mesuespershqiperine.al/VendePune/Vende>, ku publikohen vendet e lira të punës, kërkimi është i bazuar sipas renditjes:



Pasi të jenë plotësuar të dhënat sipas renditjes më sipër, mund të shfaqet një rezultat mbi kërkimin.

Gjatë auditimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, u konstatua se:

- Nuk është e mundur që të kërkohet vetëm në bazë profili, pra pa përcaktuar DRAP. Gjithashtu, nuk është e mundur të bëhet kërkim në bazë profili pa zgjedhur më parë ZVAP. Nga testimet u konstatua se kërkimet nuk janë dinamike dhe të pavarura nga njëra tjetra.
- Tek përmbajtja e njoftimeve, ku publikohen njoftimet e nevojshme në funksion të portalit “Mësues për Shqipërinë”, në adresën <https://mesuespershqiperine.al/Njoftimes>, adresat e internetit ku gjendet njoftimi nuk janë të lidhura në mënyrë që të hapen me një klikim, por vetëm duke i kopjuar këto adresa në një faqe të re kërkimi.

Fig.12: Pamje e siguruar nga portali në adresën: <https://mesuespershqiperine.al/Njoftimes>

● SQARIM MBI PIKET E KONVERTUARA TE TESTIMIT

PIKET JANE TE TE PONDERUARA ME KOEFICIENTIN 0.8. Në bazë pikës 8/2/b) të udhëzimit Nr. 15, datë 06.06.2019 “Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore informatizuar përmban 50 pyetje, përgjigjet e sakta të të cilave vlerësohen me 100% që konvertohen në linkun: <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Udhezimi-nr.-15-dt.-06.06.2019.pdf>

Postuar në: 9/11/2019 12:09:52 PM

Burimi i të dhënave: <https://mesuespershqiperine.al/>

- Në hapësirën i quajtur “Këndi i Mësuesit”, informacioni udhëzues që jepet për të afishuar rezultatet përfundimtare tregon se të dhënat filtrohen sipas numrit personal me të cilin aplikanti është regjistruar në portal ose në mënyrë alternative me numrin personal të deklaruar në dosje, adresa <https://mesuespershqiperine.al/Home/Kendi>“.

Opsioni i dhënë në adresën e mësipërme tregon se një afishim të dhënash mund të bëhet duke vendosur numrin e letërnjoftimit, ndërsa teksti shpjegues me ngjyrë të kuqe sqaron se nevojitet të vendosni numrin personal ose numrin e pasaportës që keni deklaruar në dosje. Letërnjoftimi nuk është pjesë e të dhënave në dosje, prandaj ai nuk duhet të jetë në asnjë nga kërkimet.

Fig.13: Pamje e siguruar nga portali në adresën: <https://mesuespershqiperine.al/FAQs>

Rezultatet e shpallura jane perfundimtare

Ju lutem vendosni Nr personal qe jeni regjistruar ne portal. Ne alternative mund te kerkoni me nr personal qe keni deklaruar ne dosje.


Nr leternjoftimi:

Afisho

Burimi i të dhënave: <https://mesuespershqiperine.al/>

- Përmbajtja dhe përgjigjet e pyetjeve më të shpeshta drejtuar përdorimit të portalit “Mësues për Shqipërinë” në adresën <https://mesuespershqiperine.al/FAQs>, në disa raste nuk është dhënë informacion i plotë dhe në mënyrë shteruese.

Fig.14: Pamje e siguruar nga portali në adresën: <https://mesuespershqiperine.al/FAQs>



Burimi i të dhënave: <https://mesuespershqiperine.al/>

Portali i Trajnimeve. Portali i trajnime është konceptuar në vitin 2021 bazuar në udhëzimin nr.16, datë 28.07.2021 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën nr.4186/1 prot, datë 28.07.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.

Rolet kryesore që përmban ky portal janë: Agjenci, Trajnues, Mësues dhe KAPT. Deri në fund të muajit shkurt 2023, në portal janë regjistruar:

- 130 Agjenci Trajnimesh nga të cilat 81 janë aktive;
- 1,193 module të akredituara nga të cilat 705 janë aktive;
- 11,527 trajnime të regjistruara deri në shkurt 2023;
- 44,270 mësues që janë regjistruar të paktën një herë;
- 128,103 regjistrime mësuesish në trajnime;
- 602 trajnues aktiv.

Bordi drejtues i RASH me vendimin nr.4, datë 07.03.2022, dokumentuar me shkresën nr.120 prot, datë 07.03.2022 ka miratuar tarifat e shërbimit për “Portalin e trajnimeve” për vitin 2022, kategorizuar në fashat analitike si më poshtë:

Tabela 3: Fashat e miratuara për tarifat e agjencive në portalin e trajnimeve

Fasha	Tarifa (në Euro)
Fasha 1 mbi 7500 regjistrime për t’u trajnuar në vit	7500
Fasha 2 nga 5000 deri në 7500 regjistrime për t’u trajnuar në vit	6500
Fasha 3 nga 3000 deri në 5000 regjistrime për t’u trajnuar në vit	4000
Fasha 4 nga 2000 deri në 3000 regjistrime për t’u trajnuar në vit	2500
Fasha 5 nga 1000 deri në 2000 regjistrime për t’u trajnuar në vit	1500
Fasha 6 nga 500 deri në 1000 regjistrime për t’u trajnuar në vit	850
Fasha 7 nga 100 deri në 500 regjistrime për t’u trajnuar në vit	500
Fasha 8 nga 10 deri në 100 regjistrime për t’u trajnuar në vit	100
Fasha 9 deri në 10 regjistrime për t’u trajnuar në vit	50

Burimi i të dhënave: RASH, Vendimi i bordit nr.4, datë 07.03.2022

Nga auditimi janë konstatuar disa nevoja për përmirësime, të cilat renditen më poshtë:

- Nuk janë hartuar diagramet e qarkullimit të informacionit për proceset e ofruara nëpërmjet këtij sistemi të cilat njihen ndryshe si Workflow.

- Tarifa është një e dhënë që plotësohet nga agjencitë kur shtojnë një rekord të ri për trajnimin i cili më pas publikohet në portal. Në këtë fushë mund të shënohen dhe tekst megjithëse me këtë të dhënë nevojiten të zhvillohen statistika.
- Gjatë regjistrimit mbi llojin e trajnimit mundësitë e zgjedhjes janë: i Drejtpërdrejtë, online dhe i kombinuar. Këto opsione megjithëse fikse dhe të dërguara nga KAPT- Komisioni i Akreditimit të Programit të Trajnimit, nuk rezultojnë të jenë pjesë e një liste nga e cila agjencitë të mund të zgjedhin po ata e plotësojnë këtë të dhënë manualisht.
- Orari i fillimit dhe Orari i mbarimit është i tipit tekst, ndërkohë që duhet të ishte “Time”.
- KAPT-i dërgon të dhënat për modulet si dhe të dhënat për agjencitë ku në disa raste janë në anglisht. RASH nuk ka ndërtuar një model “template” për plotësimin e fushave me të dhëna që vijnë nga KAPT-i, duke përcaktuar në këtë mënyrë se cilat janë të dhënat e detyrueshme që nevojiten për sistemin e trajnimeve.
- Përdoruesit e të gjitha kategorive nuk gjenerojnë të dhëna si output/raporte.
- Në aplikimin për trajnim që kryhet nga mësuesit të dhënat në fushat e figurës së mëposhtme janë formatuar në tipin tekst, që do të thotë se si të dhëna hyrëse për emrin, mbiemrin dhe numrin personal lejohet të regjistrohen karaktere speciale.

Fig.15: Ndërfaqja për shtimin e trajnimeve nga agjencitë

ModulID	Edukimi I aftësive sipërmarrëse për mësuesit e ciklit të ulët d
DataTrajnimit(klikoni ikonën e kalendarit)	24/03/2023
Qyteti/Njesi.Administrative	Berat
Adresa	ttttt
DataPerfundimit(klikoni ikonën e kalendarit)	25/03/2023
Tarifa	1200 leke per kredit
Trajnues	
Trajnues te tjere	
Orari.Fillimit	
Orari.Mbarimit	
Lloji.Trajnimit(I drejtperdrejte, Online, I Kombinuar)	
Shenim	

Burimi i të dhënave: Sistemi i trajnimeve

Mesazhi që del në aplikimin e mësuesit për zhvillimin e një trajnimi është se “Të gjitha fushat janë të detyrueshme për t’u plotësuar”, por aplikimi mund të ruhet pa plotësuar të dhëna mbi Institucionin Arsimor, si në figurën e mëposhtme.

Fig.16: Ndërfaqja për mësuesin gjatë aplikimit për trajnim

Të gjitha fushat janë të detyrueshme për t'u plotësuar !!!

Trajnimi i perzgjedhur										
Data.Trajnimit	Agjensia	Moduli	Kategoria	Nr.Kredite	Qyteti	Tarifa	Trajnuesi	Adresa	Ora	Kontakt
23 / 03 / 2023	BRIT'S CENTRE	ZHVILLIMI I MENDIMIT KRITIK, ZGJIDHJA E PROBLEMEVE NEPERMJET PROGRAMIMIT NE SCRATCH	Etika, komunikimi dhe pedagogjia	1	Tiranë-Qytet	1100L	ENEJDA VELIAJ	Online	17:00	694603342

Emri:

Mbiemri:

Nr. personal(ID):

Email:

Nr. telefoni:

Institucioni Arsivor:

Dar:

Za:

Apliko

Burimi i të dhënave: Portali i trajnimeve <https://trajnime.arsimi.rash.al/Trajnimes>

1.Titulli i gjetjes: Sistemet që RASH ka ndërtuar dhe i ofron IAL-ve nuk janë vënë në përdorim nga Universitetet Publike në vend.

Situata: Nga auditimi u konstatua se, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe IAL-të, e kanë vendosur Rrjetin Akademik Shqiptar në kushtet e riskut të ekzistencës së tij, pasi nuk kanë financuar për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemeve informatike që j'u ka ofruar, në kundërshtim me VKM nr.88, datë 14.02.2018, në pikën 5 ku citohet se:

“Burimet e financimit të Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar janë:

c. kontributi vjetor i anëtarësisë nga IAL-të dhe institucionet e tjera;

ç. kontributi vjetor i ministrisë përgjegjëse për arsimin, i agjencive dhe IAL-ve, sipas shërbimeve përkatëse të ofruara”.

Kriteri: VKM nr. 88, datë 14.02.2018, “Për krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH)”, pika 4 dhe 5.

Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe rektorëve të 12 universiteteve publike shqiptare, Qendra e përbashkët Ndërinstitucionale për Rrjetin Telematik - RASH, për kërkimin dhe zhvillimin me fokus Teknologjinë e informacionit dhe Telekomunikacionit.

Ndikimi/efekti: Institucioni i vetëm në vend që ndërton sisteme informatike “in house”, mund të vihet në rrezik të ekzistencës së tij pasi institucionet kanë preferuar të zhvillojnë paralelisht sistemet e tyre informatike me informatizime të pjesshme për shkak dhe të kostove të larta të ndërtimit të tyre. RASH përballlet me mundësi të pakta financiare për rinovimin e pajisjeve fizike mbi të cilat qëndrojnë këto sisteme.

Shkaku: Mos respektimi i VKM nr. 88, datë 14.02.2018, “Për krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH)”;

Mos respektimi i marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe rektorëve të 12 universiteteve publike shqiptare, Qendra e përbashkët Ndërinstitucionale

për Rrjetin Telematik - RASH, për kërkimin dhe zhvillimin me fokus Teknologjinë e informacionit dhe Telekomunikacionit.

Rëndësia: E lartë

1.1.Rekomandimi: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Institucione e Arsimit të Lartë, si anëtarë të asamblesë së Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për të vënë në funksion të administrimit të tyre akademik dhe administrativ produktet informatike që janë zhvilluar nga RASH si asete të rëndësishme në drejtim të inovacionit dhe të bashkëpunojnë në mënyrë aktive në përmirësimin e tyre, pasi vetëm në këtë mënyrë do të mund të informatizojnë më shumë procese dhe me më pak kosto financiare.

2.Titulli i gjetjes: Nga auditimi mbi sistemin “*Pitagora*”, moduli “*Programe*”, u konstatua se e drejta për fshirjen e të dhënave që disponojnë përdoruesit, krijon nevojë për suport të shpeshtë tek të dedikuar në mirëmbajtjen që ofrohet nga RASH.

Situata: Nga auditimi mbi strukturën e ngritur të sistemit “*Pitagora*” u konstatua se:

- Përdoruesve të sistemit me kërkesë të tyre ju është dhënë aksesimi për fshirje të të dhënave nga ndërfaqja. Nga kjo e drejtë, krijohen disa problematika të cilat i adresohen për zgjidhje RASH-it, duke rritur nevojën për suport të shpeshtë në rikthimin e të dhënave.

Programi Pitagora është konceptuar dhe ndërtuar në mënyrë të tillë që kurrikula të lëvizet nga një program në një tjetër e gjithashtu t’i ndryshohet emri nëse është e nevojshme. Kjo do të thotë se veprimet e fshirjes nuk ka asnjë arsye të kryhen në sistem nga përdoruesit fundor që marrin këtë shërbim të cilët janë punonjës të universiteteve. Veprimi i fshirjes së Kurrikulës, në rastin kur është populluar me të dhënat e studentit, shoqërohet dhe me fshirjen e të dhënave të studentit/studentëve për këtë kurrikul. Modifikimi i kurrikulës rezulton të jetë problemi më shpesh i raportuar dhe më me impakt tek të gjithë përdoruesit në lidhje me përdorimin e sistemit “*Pitagora*”.

Fshirja e kurrikulës ndodhë nisur nga fakti se mungon parametrizimi në sistemin Pitagora për lejimin e fshirjes, pasi nuk është bërë një ndarje e këtij veprimi sipas popullimit, në mënyrë që:

- a. Fshirja e kurrikulës kur ajo sapo është krijuar, pra në kushtet kur të dhënat e studentit nuk janë populluar;
- b. Fshirja e kurrikulës kur ajo është vendosur në programin e gabuar, por ka dhe të dhënat e studentit.

Nga auditimi mbi krijimin, plotësimin si dhe fshirjen e kurrikulës u konstatua se:

- Gjatë plotësimit të të dhënave në fushën “*Mënyra e vlerësimit*” është vendosur si një nga mënyrat dhe opsioni “*Mbrojtje Anglishteje*”, në vend të mbrojtje gjuhë e huaj duke qenë se MAS ka një listë gjuhësh të miratuara si të detyrueshme për programet studimore për tipin “*Master*”.

- Në krijimin e një kurrikule nuk përcaktohet tipi i saj nëse është “*Provim*” apo “*Firmë*”.

- Nuk shfaqet mesazh gabimi në rast se veprohet nga përdoruesi për ndryshimin e kodit të lëndës në modul “*Lëndët*”, megjithëse ndryshimet nuk ruhen kur kodi i përket një lënde tjetër.

- Tek regjistrimi i elementëve mësimor në modul “*Programet*” lista e elementëve është me shkurtime dhe jo emërtime të plota si: Leksion, Seminar, Praktikë, Ushtrime, Laboratorë, etj.

Kriteri: Fshirja është një veprim që nuk duhet lejuar nisur nga standardet më të mira të sigurisë së të dhënave dhe ndërtimit të sistemeve informatike.

Ndikimi/efekti: Veprimi i fshirjes së Kurrikulës, në rastin kur është populluar me të dhënat e studentit, shoqërohet dhe me fshirjen e të dhënave të studentit/studentëve për këtë kurrikul, çfarë krijon nevojën për rikthim të të dhënave nga ana e RASH.

Shkaku: E drejta për fshirjen e të dhënave, ndërkohë që sistemi lejon të bëhen ndryshime në rastet e gabimeve njerëzore. Mungesa e parametrizimit të nevojshëm në fshirjen e kurrikulës.

Rëndësia: E lartë

2.1.Rekomandimi: Drejtuesit e institucionit të Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për sistemimin e problematikave të konstatuara nga auditimi në modulën “*Programe*” të sistemit Pitagora. Gjithashtu, të ri konceptohet kodi i ndërtuar për fshirjen e kurrikulës duke mbajtur në konsideratë që fshirja të mos ndodhë në asnjë rast kur kurrikula është populluar me të dhëna për studentin, por të lejohen lëvizjet e saj në programe të ndryshme dhe modifikimet në të dhëna që lejohet ndryshimi.

3.Titulli i gjetjes: Nga auditimi mbi sistemin “*Pitagora*”, moduli “*Studentët/Regjistrimi manual i studentëve*”, u konstatua se mungojnë disa parametrizime.

Situata: Nga auditimi mbi sistemin “*Pitagora*”, konkretisht në modulën “*Studentët/Regjistrimi manual i studentëve*”, u konstatua se:

- Në modifikimet e të dhënave për studentët e importuar lejohen të bëhen modifikime në të gjitha fushat përveç programit. Fushat, ku mund të jetë i nevojshëm modifikimi janë: mbiemri, numri i matrikullimit, e-mail, telefon, vendbanimi, gjendja civile.
- Fushat, të dhënat e të cilave zgjidhen nga një listë si “Programi” dhe “Gjendja e Studentit”, nuk janë të renditura sipas rendit alfabetik.
- Me zgjedhjen e gjendjes së studentit në fushën “Gjendja e Studentit”, nuk janë përcaktuar fushat tek të cilat mund të kryhen modifikime ose plotësime.
- Me zgjedhjen e opsionit “I transferuar” e cila tregon se studenti ka transferuar studimet nga një program në një tjetër, fusha që nevojitet të plotësohet është “Universiteti nga është transferuar” e cila nuk është e tipit listë, duke mundësuar që të dhënat të mos shkruhen në forma të ndryshme kur nevojitet të themi të njëjtin emërtim.
- Në listën e të dhënave të fushës “Gjendja e Studentit” janë vendosur disa emërtime në Italisht, kur gjuha e ndjekur në aplikacion është gjuha shqipe.
- Në fushën “Datëlindja”, ku plotësohet data e lindjes së studentit, nuk janë implementuar mesazhe informuese për përdoruesit në rastet e pasaktësisë në plotësimin e saj si shembull: data nuk është plotësuar në formatin e kërkuar, ose data e lindjes nuk mund të jetë më pak se 18 vite.
- Nuk janë implementuar kontrole kufizuese mbi karaktere speciale në fushat Emër, Atësi, Mbiemër. Plotësimi i këtyre të dhënave nuk mund të përmbajë karaktere speciale.
- Fushat “Shkolla e Mesme”, “Vendlindja” dhe “Shtetësia” nuk janë në formën listë, çfarë mundëson që të dhënat të mos shkruhen në forma të ndryshme për të njëjtin emërtim.
- Në të gjitha fushat që mund të modifikohen, mund të plotësohen me operatorët logjikë OR dhe AND.
- NID është një e dhënë e konceptuar si unike e cila nuk mund të ndryshohet pasi ka përfunduar regjistrimi i studentit, por kjo e dhënë është kërkuar të modifikohet nga disa universitete në rastet kur është regjistruar gabim apo është importuar nga të dhëna të sistemit të mëparshëm. Nga auditimi u konstatua se nuk janë shtuar kontrole paralajmëruese përpara ruajtjes së regjistrimit të studentit për të dhënë e NID si e dhënë e pandryshueshme, çfarë ndihmon përdoruesin të kontrollojë të dhënat e regjistruara.

Nga auditimi mbi modulën “*Krijo Orar/ Orari Mësimor/ Orar jo periodik*”, dhe në modulën *Krijo Orar/ Orari Mësimor/ Orari për përsëritës* u konstatua se:

- Në opsionin e krijimit të orarit të provimeve, nuk janë implementuar kontrole parandaluese mbi formatin e datës së provimit në modulën.
- Të dhënat që zgjidhen nga një listë si “Pedagogu”, nuk janë renditur sipas rendit.
- Tek orari periodik mund të plotësohen të dhëna mbi orarin mësimor, por aktualisht është një funksionalitet që nuk është vënë në përdorim nga universitetet.

Kriteri: Tipet e të dhënave në parametrizimet e sistemeve informatike.

Ndikimi/efekti: Të dhëna “Input” jo të strukturuar dhe të unifikuar.

Shkaku: Mungesa e punonjësve, mungesa e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve për përmirësimin dhe lehtësimin e proceseve të informatizuara.

Rëndësia: E lartë

3.1.Rekomandimi: Drejtuesit e institucionit të Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për adresimin dhe zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga auditimi në modulën “*Studentët/Regjistrimi manual i studentëve*” të sistemit Pitagora. Gjithashtu, të implementohen kontrole kufizuese të tipit “Error” apo informuese të tipit “Override” të cilat respektivisht parandalojnë apo njoftojnë për një kontroll të të dhënave që përdoruesi po regjistron, duke parandaluar gabime njerëzore e detyrimisht dhe nevojën për suport.

4.Titulli i gjetjes: Nga auditimi mbi sistemin “*Pitagora*”, konkretisht në modulën “*Evidencat*”, u konstatua se ka munguar bashkëpunimi ndërinstitucional për ndërtimin e raporteve specifike për çdo universitete që merr shërbim për sistemin Pitagora.

Situata: Nga auditimi mbi sistemin “*Pitagora*”, konkretisht në modulën “*Evidencat*”, u konstatua se:

- Universitetet nuk kanë kërkuar raporte mbi të dhëna të ndryshme si: plani mësimor, totalin e leksioneve, totalin e seminareve, totalin e laboratorëve, totalin e praktikave për javë mësimi si dhe për vit akademik, Orët jashtë orarit etj.
- Evidencat identifikohen nëpërmjet një kodi dhe emërtimi, por nuk ka një fushë përshkrimi ku të jepen detaje përshkruese mbi të dhënat që gjenerohen me secilin prej raporteve, çfarë do lehtësonte ngarkesën e sistemit dhe informim paraprak për përdoruesin.

Kriteri: Të dhënat “Output” që ofrohen nëpërmjet raportimit nga sistemi.

Ndikimi/efekti: Raportimi mbi të dhënat që kanë hyrë në sistem është i nevojshëm për përdoruesit dhe vendimmarrjen organizative të universiteteve.

Shkaku: IAL-të në kushtet kur nuk kryejnë pagesa për shërbimet që marrin nga RASH, nuk kanë bashkëpunuar për kërkesa të veçanta apo që përmirësojnë sistemin si për të dhënat hyrëse “Input” ashtu dhe për ato raportuese “Output”.

Rëndësia: E lartë

4.1.Rekomandimi: Rrjeti Akademik Shqiptar dhe Universitetet që marrin shërbim për sistemin Pitagora, të bashkëpunojnë në ndërtimin e raporteve specifike dhe të bazuara në kërkesa konkrete dhe të mos mjaftohen me raportet e ndërtruara aktualisht, duke mbajtur në konsideratë faktin që për çdo të dhënë hyrëse në sistem mund të gjenerohet një raport, çfarë do ju shërbente më tej të gjitha palëve në analiza, statistika si dhe vendimmarrje.

5.Titulli i gjetjes: Nga auditimi mbi sistemin “*Mësues për Shqipërinë*”, u konstatua se disa parametrizime që lehtësojnë veprimet tek përdoruesit dhe mirëmbajtja që ofron RASH, janë të nevojshme.

Situata: Nga auditimi mbi sistemin “*Mësues për Shqipërinë*”, u konstatua se:

- Tek “*Regjistrimi*”, mësuesi hap llogarinë personale për herë të parë. Për ngarkimin e dosjes është konceptuar një fushë në të cilën bashkëngjitet duke upload-uar dokumentet që mësuesi dorëzon në aplikim. Për t’ju ardhur në ndihmë përdoruesve që në këtë rast janë mësues, është vendosur një tutorial i cili udhëzon në anglisht se si të bëhen “zip” dokumentet për aplikim, gjuhë e cila nuk njihet nga çdo mësues.
- Nuk janë implementuar kontrole mbi datën e lindjes së mësuesit që plotësohet në regjistrimin fillestar të tij, që do të thotë se të dhënat e datës së lindjes mund të jenë çfarëdo.
- Në fushat që plotëson mësuesi për Emrin, Atësinë dhe Mbiemrin nuk janë implementuar kontrole të karaktereve numerike apo speciale, pra këto të dhëna mund të plotësohen duke vendosur karaktere të tipit: “,/] etj.
- Fushat e detyrueshme nuk janë identifikuar me tregues specifik si “*” apo ngjyrë tjetër, e cila i tregon përdoruesit, se nuk mund të vazhdojë më tej pa bërë plotësimet e nevojshme. Për

plotësimin e fushave të detyrueshme nuk janë implementuar kontrolle me plotësimin e tyre hap pas hapi. Një kontroll është implementuar në butonin e fundit “regjistrohu”, që shërben për ruajtjen e aplikimit.

- Numri personal me numrin e pasaportës janë konceptuar në të njëjtën fushë, por këto dy numra nuk kanë të njëjtin format. Nisur nga kjo, nuk implementohen dot kushte parandaluese në hedhjen e të dhënave të sakta për formatin e NID-it dhe numrit të pasaportës.
- Nuk është vendosur një maskë orientuese për numrin që nevojitet të plotësohet nga përdoruesi si në rastin e datëlindjes.
- Me zgjedhjen e opsionit “Konfirmo s ‘kualifikimin / përjashtimin e kandidatit”, nuk ka një fushë të detyruar ku të jepet arsyet e refuzimit nga DRAP, të dhëna të nevojshme për DPAP- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.
- Fusha “Shënim” është e njëjta fushë ku mund të shkruajmë apo ndryshojmë të gjitha nivelet e përdoruesve: DRAP – Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, DPAP- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe ZVAP- Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar. Pra, në këtë fushë shënimin i kryer nga DRAP mund të ndryshohet nga DPAP apo ZVAP dhe anasjelltas, çfarë pengon shënimet të mbeten si rekorde për efekt kontrolli apo gjurme në secilën nga fazat e vlerësimit.

Kriteri: Tipet e të dhënave si dhe parametrizime të domosdoshme në sistemet informatike.

Ndikimi/efekti: Të dhëna “Input” jo të strukturuar dhe të unifikuar.

Shkaku: Mungesa e punonjësve dhe ngarkesa në suport të shumë sistemeve.

Rëndësia: E lartë

5.1.Rekomandimi: Drejtuesit e institucionit të Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga auditimi në sistemin “Mësues për Shqipërinë”, me qëllim përmirësimin, strukturimin dhe unifikimin e të dhënave hyrëse, duke minimizuar në këtë mënyrë parregullsi të përdoruesve dhe nevojën për suport.

6.Titulli i gjetjes: Nga auditimi mbi sistemin “Mësues për Shqipërinë”, u konstatua se disa parametrizime që lehtësojnë veprimet tek përdoruesit që në këtë rast janë mësuesit dhe mirëmbajtja që ofron RASH, janë të nevojshme.

Situata: Nga auditimi mbi portalin “Mësues për Shqipërinë”, u konstatua se:

- Në adresën: <https://mesuespershqiperine.al/VendePune/Vende>, ku publikohen vendet e lira të punës, kërkimet nuk janë dinamike dhe të pavarura nga njëra tjetra. Nuk është e mundur që të kërkohet mbi vendet bosh të punës në bazë profili, pa përcaktuar DRAP. Gjithashtu, nuk është e mundur të bëhet kërkim në bazë profili pa zgjedhur më parë ZVAP. Nga testimet u konstatua se., kërkimi është i bazuar sipas renditjes: Cakto DRAP-> Zgjidh ZVAP->Zgjidh Profilin. Vetëm pasi të jenë plotësuar të dhënat sipas renditjes më sipër, mund të shfaqet një rezultat mbi kërkimin.
- Tek përmbajtja e njoftimeve, ku publikohen njoftimet e nevojshme në funksion të portalit “Mësues për Shqipërinë”, në adresën <https://mesuespershqiperine.al/Njoftimes>, adresat e internetit ku gjendet njoftimi nuk janë të lidhura që të hapen me një klikim, por vetëm duke i hapur këto adresa në një faqe të re kërkimi.
- Në hapësirën e quajtur “Këndi i Mësuesit”, informacioni udhëzues që jepet për të afishuar rezultatet përfundimtare tregon se të dhënat filtrohen sipas numrit personal me të cilin aplikanti është regjistruar në portal ose në mënyrë alternative me numrin personal të deklaruar në dosje, adresa <https://mesuespershqiperine.al/Home/Kendi>. Opsioni i dhënë në adresën e mësipërme tregon se një afishim të dhënash mund të bëhet duke vendosur numrin e letërnjoftimit, ndërsa teksti shpjegues sqaron se nevojitet të vendosni numrin personal ose numrin e pasaportës që keni deklaruar në dosje. Letërnjoftimi nuk është pjesë e të dhënave në dosje, prandaj ai nuk duhet të jetë në asnjë nga kërkimet.

- Përmbajtja dhe përgjigjet e pyetjeve më të shpeshta drejtuar përdorimit të portalit “Mësues për Shqipërinë” në adresën <https://mesuespershqiperine.al/FAQs>, në disa raste nuk është dhënë informacion i plotë dhe në mënyrë shteruese.

Kriteri: Parametrizim i portalit për lehtësimin e hapave që ndjek përdoruesi që në këtë rast janë mësuesit.

Ndikimi/efekti: Vështirësi në përdorim si dhe në kërkim të informacionit që i nevojitet përdoruesit që për këtë sistem janë mësuesit, të cilët jo në të gjitha rastet kanë njohuri të mjaftueshme në përdorimin e sistemeve.

Shkaku: Mungesa e punonjësve dhe ngarkesa në suport të shumë sistemeve.

Rëndësia: E lartë

6.1.Rekomandimi: Drejtuesit e institucionit të Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për adresimin dhe zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga auditimi në sistemin “*Mësues për Shqipërinë*”, me qëllim përmirësimin, strukturimin dhe unifikimin e të dhënave hyrëse, çfarë do të minimizojë parregullsitë e përdoruesve, si dhe nevojën për suport.

7.Titulli i gjetjes: Nga auditimi mbi sistemin “*Portali i Trajnimeve*”, u konstatua se disa parametrizime që lehtësojnë veprimet tek përdoruesit dhe mirëmbajtja që ofron RASH, janë të nevojshme.

Situata: Nga auditimi mbi sistemin “*Portali i Trajnimeve*”, u konstatua se:

- Tarifa e trajnimit është një e dhënë që plotësohet nga agjencitë kur shtojnë një rekord të ri për trajnimin i cili më pas publikohet në portal. Në këtë fushë mund të shënohen dhe tekst megjithëse me këtë të dhënë nevojiten të zhvillohen statistika nga ana e RASH.

- Gjatë regjistrimit mbi llojin e trajnimit mundësitë e zgjedhjes janë: i Drejtpërdrejtë, online dhe i kombinuar. Këto opsione megjithëse fikse dhe të dërguara nga KAPT- Komisioni i Akreditimit të Programit të Trajnimit, nuk rezultojnë të jenë pjesë e një liste nga e cila agjencitë të mund të zgjedhin po ata e plotësojnë këtë të dhënë manualisht.

- Orari i fillimit dhe Orari i mbarimit është i tipit tekst, ndërkohë që duhet të ishte “Time”.

- KAPT-i dërgon të dhënat për modulet si dhe të dhënat për agjencitë ku në disa raste janë në anglisht. RASH nuk ka ndërtuar një model “template” për plotësimin e fushave me të dhëna që vijnë nga KAPT-i, duke përcaktuar në këtë mënyrë se cilat janë të dhënat e detyrueshme që nevojiten për sistemin e trajnimeve.

- Përdoruesit e të gjitha kategorive nuk gjenerojnë të dhëna si output/raporte.

- Në aplikimin për trajnim që kryhet nga mësuesi të dhënat hyrëse për emrin, mbiemrin dhe numrin personal janë formatuar në tipin tekst, që do të thotë se si të dhëna lejohet të regjistrohen karaktere speciale.

- Mesazhi që del në aplikimin e mësuesit për zhvillimin e një trajnimi është se “*Të gjitha fushat janë të detyrueshme për t’u plotësuar*”, por aplikimi mund të ruhet pa plotësuar të dhëna mbi Institucionin Arsimor.

Kriteri: Tipet e të dhënave në parametrizimet e sistemeve informatike.

Ndikimi/efekti: Të dhëna “Input” jo të strukturuar dhe të unifikuar.

Shkaku: Mungesa e punonjësve dhe ngarkesa në suport të shumë sistemeve.

Rëndësia: E lartë

7.1.Rekomandimi: Drejtuesit e institucionit të Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për sistemin e problematikave të konstatuara në sistemin “*Portali i Trajnimeve*”, duke përmirësuar në këtë mënyrë strukturimin dhe unifikimin e të dhënave hyrëse e njëkohësisht duke minimizuar parregullsi të përdoruesve dhe nevojën për suport.

8.Titulli i gjetjes: Nga auditimi mbi sistemet informatike u konstatua se janë të nevojshme disa unifikime në të gjitha sistemet.

Situata: Nga auditimi mbi sistemet informatike që ka ndërtuar RASH si “Pitagora”, “Mësues për Shqipërinë”, “Portali i Trajnimeve”, u konstatua se mungojnë:

- Diagramet e qarkullimit të informacionit për proceset e ofruara nëpërmjet këtij sistemi të cilat njihen ndryshe si Workflow, të cilat përcaktojnë hyrjen e informacionit, përpunimin dhe raportimin e tij;

- Në mënyrë të unifikuar shenjat simbolizuese në të dhënat e detyrueshme që kërkohen dhe njihen si “mandatory filed”, tipet e të dhënave mbi datën, kohën si dhe të dhënat e tipit listë të përcaktuara për të dhënat që janë me zgjedhje.

Kriteri: Praktikrat më të mira në ndërtimin dhe dokumentimin e rrjedhës së informacionit dhe fushave të detyrueshme.

Ndikimi/efekti: Shenjat simbolizuese të njëjta lehtësojnë dhe nuk i krijojnë konfuzion përdoruesve që shpesh nuk janë të orientuar nga sistemet informatike. Workflow shërben si dokumentim i qarkullimit të informacionit për çdo palë të interesuar përfshirë këtu dhe audituesit, që nëpërmjet këtij dokumenti kuptojnë sistemin.

Shkaku: Ngarkesa për mirëmbajtjen e shërbimeve, numri i ulët i punonjësve duke qenë se ata janë programuesit e zgjidhjeve informatike dhe mirëmbajtësit e shërbimeve që ofrohen, si dhe ata që nevojitet të dokumentojnë proceset e informatizuara.

Rëndësia: E lartë

8.1.Rekomandimi: Drejtuesit e institucionit të Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për zgjidhjen e problematikave të njëjta që janë identifikuar gjatë auditimit në sistemet Pitagora”, “Mësues për Shqipërinë” dhe “Portali i Trajnimeve”.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 1, datë 07.04.2023, protokolluar në RASH me shkresën nr. 151, datë 07.04.2023, si dhe është trajtuar në faqet 8-28 të Projektraportit të Auditimit mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione.

2.2 Siguria, ruajtja e informacionit si dhe ndërveprimi për bazat e të dhënave që janë krijuar apo administrohen nga RASH.

Siguria e informacionit është bërë gjithnjë e më shumë e rëndësishme për institucionet, kjo vjen si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit mund të përcaktohet si metoda e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me kushtet e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë.

Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion publik shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TI, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TI”.

Detyrat të cilat janë kritike për Sigurinë e Informacionit duhet të jenë të mirë përcaktuara dhe të dokumentuara. Punonjësit të cilëve u janë ngarkuar këto detyra, duhet të njohin përgjegjësitë e tyre referuar mbrojtjes së aseteve të informacionit të institucionit, përfshirë të dhënat elektronike, infrastrukturën e SI, dokumentet, etj. Rishikim për përcaktim të përshtatshëm të detyrave kritike, për të cilat kërkohen kontrole të sigurisë. Ndarja e detyrave duhet përcaktuar qartë midis menaxhimit dhe operacioneve të sigurisë së IT.

Politikat e pozicionimit të personelit IT, transferimi dhe qarkullimi, ashtu si edhe shkëputja e marrëdhënieve të punës është e qartë për të reduktuar pavarësinë e individëve. Duhet të ketë mekanizma që përdoren për transferimin e njohurive.

Politikat e sigurisë së IT vendosin kërkesat për mbrojtjen e aseteve të informacionit që i referohen procedurave ose mjeteve të tjera në mënyrën sesi këto do të mbrohen. Politikat duhet të jenë të disponueshme ndaj të gjithë punonjësve përgjegjës për sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të institucionit të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit. RASH ushtron funksionin bazuar në rregulloren për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe mjeteve të komunikimit të qendrës ndërinstitucionale të rrjetit akademik shqiptar. Kjo rregullore është e përgjithshme duke mos përfshirë në detaje elementet e politikave të sigurisë.

Nga auditimi u konstatua se:

- RASH ka miratuar rregulloren për Sigurinë e Informacionit me urdhër nr. 9111 prot., datë 28.03.2019, me zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Departamenti i Infrastrukturës dhe Rrjetit Telematik. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i parimeve dhe rregullave të Përgjithshme të Sigurisë së Informacionit në RASH.

2.2.a Menaxhimi i Incidenteve, Problemeve, Ndryshimeve dhe Regjistri i riskut.

Për periudhën e audituar, në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti dhe mbështetja teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve.

Për këtë duhet të ketë procedura të dokumentuara për zbulimin dhe regjistrimin e kushteve të parregullta.

Nga auditimi u konstatua se:

- Institucioni nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT.

Identifikimi i risqeve çon në gjetjen e zgjidhjeve për t'i trajtuar ato dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen dhe në mënyrë që funksionet e institucionit të jenë të mbrojtura.

- Institucioni nuk disponon procedura të dokumentuara për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive për kryerjen e ndryshimeve.

Regjistri i Riskut, përfaqëson një dokument të projektuar në formën e matricës monitoruese, në të cilin evidentohet informacion mbi riskun e identifikuar, riskun e qenësishëm (para kontrolleve) dhe riskun pas kontrolleve duke evidentuar gjithashtu nevojën për kontrolle të mëtejshme, etj.

Nga auditimi u konstatua se:

- RASH për vitin 2021 ka miratuar regjistrin e riskut me urdhër nr. 21/46 prot., datë 05.02.2021, për vitin 2022 ka miratuar regjistrin e riskut me urdhër nr. 134 prot., datë 10.03.2022.

Pasja e një regjistri risku bazohet në nenin 11, pika 2, neni 12 pika 3/d dhe nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, UMF nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

2.2.b Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet

RASH ka përshtatur një ambient të posaçëm (DataCenter) për pajisje specifike që janë:

- a. Rack
- b. Server
- c. Switch dhe router
- d. NVR për kamerat e sigurisë
- e. Sistemi i alarmit kundër zjarrit

Kjo dhomë administrohet nga Departamenti i Infrastrukturës dhe Rrjetit Telematik.

Detyrat e Departamentit të Infrastrukturës dhe Rrjetit Telematik janë të përcaktuara edhe në Rregulloren e Brendshme të Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar.

Disa nga detyrat funksionale që punonjësit e këtij departamenti kryejnë janë:

- Mbikëqyrja e funksionimit të rrjetit Telematik universitar dhe e realizimit të shërbimeve përkatëse;
- Zbatimi i kërkesave të universiteteve lidhur me pikat e rrjetit;
- Administrimi i rrjetit Telematik dhe zgjidhja e problematikave brenda një kohe të shkurtër;
- Implementimi i Infrastrukturës së Datacenter-it dhe mbikëqyrja e realizimit të tij;
- Administrimi i serverëve dhe Infrastrukturës së Datacenter-it;
- Etj.,

Nga auditimi u konstatua se, në lidhje me proceset e kontrollit me qëllim parandalimin e incidenteve apo kontrolleve të vazhdueshmërisë së funksionimit normal të proceseve të punës së dhomës së serverëve janë vetë punonjësit e Departamentit të Infrastrukturës dhe Rrjetit Telematik në RASH që i kryejnë këto kontrolle. Gjë që tregon se kjo strukturë ka kapacitete të konsiderueshme në mirëmbajtjen dhe menaxhimin e infrastrukturës.

Verifikimi i shkallës së sigurisë së dhomës së serverëve me qëllim parandalimin e vjedhjes ose të dëmtimit të pajisjeve kompjuterike, aksesit të paautorizuar, kopjimit ose shikimit të informacionit sensitivë.

2.2.c Ambienti fizik i dhomës së serverëve

Auditimi mbi shkallën e sigurisë së dhomës së serverëve, u krye në bazë të manualit të auditimit TI, ISSAI 5310 dhe ISO 27001, rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve (*versioni 1.0, datë 02.12.2008*) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK për administratën publike si dhe neneve 12 dhe 13 të rregullores së IT në RASH mbi sigurinë fizike në ambientin e Datacenter-it.

Në ambientet e godinës janë instaluar sistemet e kontrollit të aksesit, ku punonjësit janë të pajisur me karta të personalizuar në mënyrë që të bëjnë të mundur identifikimin e secilit prej tyre në sistem. Këto ambiente monitorohen me kamera, ka sistemin e mbrojtjes nga zjarri etj. Duke qenë se dhoma e serverëve është pika më delikate e një sistemi informatik dhe përqendrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është më i lartë se në ambientet e tjera të punës, dëmet eventuale të shkaktuara në këtë ambient do të sillnin probleme serioze në funksionimin e të gjithë sistemit.

Për këtë qëllim, grupi i auditimit, të shoqëruar nga personat përgjegjës të Departamentit të Infrastrukturës dhe Rrjetit Telematik zhvilloi verifikimin e dhomës së serverave të lokalizuar në katin e parë të një prej godinave të RASH ku janë hostuar (2 Shasi me Blade Server ku janë aktive 18 copë model: PowerEdgeM610, 4 x HPE ProLiant DL380 Gen10 Server, 3 x PowerEdge R640 Rack Server, 1 x HPE ProLiant DL380 Gen9 Server dhe 1 x PowerEdge R5100 Rack Server) rack-et me serverat e sistemeve: si dhe servera dhe pajisje të tjera.

Fig.17: Pamjet e dhomës së serverëve



Burimi: Grupi i Auditimit

RASH e ka ndërtuar këtë infrastrukturë dhe është funksionale dhe operativ në mbështetje të të gjithë shërbimeve që ofron që prej viteve 2016-2017. Pra, vazhdon të jetë funksionale për një periudhë pothuajse prej 7 vitesh.

Me shkresën nr. 3698 prot., datë 10.04.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për riorganizimin e zyrave ku RASH caktohet në mesin ku aktualisht ndodhet të administrojë vetëm katin e parë të kësaj godine.

Me VKM nr. 56, datë 29.1.2020 është bërë kalimi në përgjegjësi administrimi nga Akademia e Shkencave tek Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), të objektit “Instituti Meteorologjik”.

RASH si institucion i cili duhet të zhvilloj dhe promovojë projekte të kërkim-zhvillimit dhe inovacionit në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) për arsimin dhe shkencën, si dhe për krijimin e infrastrukturës për ngritjen e një qendre të përbashkët ndërdisiplinore kërkim - zhvillimi (TIK) nga IAL-të pjesëmarrëse apo palë të treta, nuk disponon një ambient të vetin për të ofruar shërbimet sipas VKM-së nr. 88, datë 14.2.2018 “Për Krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH)”.

Nisur nga sa më sipër godina në të cilën është ndërtuar dhe investuar për dhomën e serverave është në një ambient afër vetë godinës ku ky institucion aktualisht kryen detyrat funksionale por që nuk është në dispozicion nga Rrjeti Akademik Shqiptar, por me VKM-në nr. 56 datë 29.1.2020 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Akademia e Shkencave tek Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), të objektit “Instituti Meteorologjik” dhe për një ndryshim në Vendimin nr. 440, datë 16.06.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Akademisë së Shkencave”, të ndryshuar”, i përket institucionit të ASCAL. Kjo ka kosto shtesë në rast të ndodhjes së ndonjë fatkeqësie apo edhe lëvizjes së kësaj godine duke përfshirë konfigurimet e rrjetit dhe infrastrukturës teknologjike, kabinetet, elementet e dyshemesë teknologjike apo tavanit të varur që ndryshojnë në varësi të pajisjeve, dimensioneve, mënyrës së qarkullimit të ajrimit, të kalimit të kabllimeve etj, për këtë arsye kjo është një pjesë mjaft e rëndësishme e zinxhirit të infrastrukturës fizike pasi është themeli mbi të cilën teknologjia e informacionit dhe rrjetit të telekomunikacionit mbështetet për një arsye

jo pak të rëndësishme siç është ruajtja e informacionit dhe vazhdueshmërisë së procesit të punës. Gjithashtu edhe shtrimi i linjës së fibrës optike të marrë nga Gèant ka kosto më vete. Megjithëse të gjitha IAL-të janë bërë pjesë e marrëveshjes ndërinstitucionale, jo të gjitha universitete marrin shërbime nga RASH, duke qenë se disa prej universiteteve kanë zgjedhur të mos e marrin si shërbim nga ky institucion.

Tabela 4: Universitetet që marrin shërbim për infrastrukturën nga RASH

Institucioni	Shërbimi Infrastruktura i ofruar nga RASH
Universiteti i Tiranës	Rrjeti, Interneti, Gèant services
Universiteti Politeknik i Tiranës	Rrjeti, Interneti, Gèant services
Universiteti i Mjekësisë	Rrjeti, Interneti, Gèant services
Universiteti i Sporteve	Interneti, Gèant services
Universiteti i Arteve	Rrjeti, Interneti, Gèant services
Universiteti i Bujqësor	Rrjeti, Interneti, Gèant services
Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës	Rrjeti, Interneti, Gèant services
Universiteti Fan Noli Korçë	Rrjeti, Interneti, Gèant services

Burimi: Të dhëna nga RASH

2.2.d Planet e vazhdimësisë së punës dhe procedurat e backup

Qëllimi i procedurës së kryerjes së backup-it të sistemeve në përdorim është që të sigurojë metoda dhe procedura të standardizuara mbi këto procese, duke siguruar kështu ruajtjen e të dhënave të serverave dhe mundësimin e rikthimit të këtyre të dhënave në raste të defekteve kritike ose rasteve të tjera të humbjes së të dhënave.

Ruajtja e të dhënave (backup)


- Backups kryhen në nivele të ndryshme. Backup-i i databazave Production kryhet çdo dy orë dhe ruhet për 30 ditë në NAS nga ku çdo muaj arkivohet një prej tyre për efekte historiku.
- Backup-i i makinave virtuale kryhet çdo 24 orë dhe ruhet për 28 ditë në dy storage të ndryshëm.

Testimet e Backupit

Backup-i i databazave testohet rregullisht çdo ditë duke i kaluar nëpër ambiente të ndryshme (Prod -> Test -> Dev) dhe të dhënat verifikohen nga zyra e Helpdesk dhe zyra e Zhvillimit. Integriteti i Backup-eve për makinat virtuale ofrohet nga Veeam Backup & Replication i cili njofton rregullisht nëpërmjet e-mail zyrën e Infrastrukturës për gjendjen e Backup-eve. Procedura e krijimit dhe informimit të problematikave të përdoruesve konsiston në hapat si në vijim:

- Përdoruesi i referohet këtyre mënyrave për krijimin e një problematike: sistemit ticket (helpdesk@rash.al); email drejtuar stafit support të RASH ose emailit support@rash.al. Për marrjen e kërkesave të reja, zhvillohen takime me përfaqësuesit e tyre.
- Pas marrjes së kërkesës, stafi i RASH vlerëson problematikën dhe jep një afat në zgjidhjen e saj.
- Pas zgjidhjes së problematikës, grupi suport dërgon email me zgjidhjen përkatëse.

Fig.18: Paraqitja skematike e Infrastrukturës në RASH



Në nenin 9 të Rregullores së Brendshme të Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar miratuar me urdhër nr. 18/42 prot., datë 18.09.2018, e cila ka në përmbajtje realizimin e qëllimit të saj nëpërmjet kryerjes së veprimtarisë së Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar, një nga veprimtaritë që ky institucion duhet të kryejë është edhe marrja e masave të nevojshme të sigurisë dhe të ruajtjes së informacionit (back up) për bazat e të dhënave që krijon ose administron RASH.

Nga auditimi u konstatua se: Procedura e ndjekur për kryerjen e backup-ve nuk është e pasqyruar apo e dokumentuar në një dokument administrativ si Rregullore e Brendshme apo dokument tjetër TIK ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesin e ruajtjes së të dhënave për sistemet në përdorim nga punonjësit e RASH.

2.2.e Mbi ndërveprimin e bazës së të dhënave

Bazuar në urdhrin nr. 5, datë 31.12.2018 “Për miratimin e dokumentit për Strategjinë e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar” në pikën b) që përcakton veprimtarinë që ky institucion kryen është edhe ndërveprimi i bazave të të dhënave për të gjithë anëtarësinë e RASH.

Nga auditimi u konstatua se bazat e të dhënave nuk ndërveprojnë ndërmjet tyre. Të dhënat ekstrahohen nga sistemi përkatës dhe ngarkohen manualisht për procese të caktuara. Baza e të dhënave ndërvepron vetëm me aplikacionin respektiv dhe nuk ka ndërveprim me një sistem tjetër jashtë RASH.

Marrja e të dhënave, komunikimin si dhe koordinimin ndërinstitucional të proceseve të përbashkëta teknike sipas fushës së kompetencës si p.sh., me QSHA, MASR dhe institucione të tjera të përfshira bëhet në formë elektronike me urdhër të ngritur nga titullari i institucionit për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e këtij urdhri. Të dhënat që duhen për vijimin e procesit të punës merren elektronikisht çdo vit në fazën e caktuar.

Për të pasur një siguri më të lartë mbi ndërveprimin në kohë reale me të dhënat që i nevojiten RASH këto të dhëna duhet të gjenerohen dhe përdoren nga sistemi për të përcaktuar nëse transmissioni i kryer është plotësuar përshtatshëm.

2.2.f Mbi verifikimin e dokumentimit të planeve për vazhdueshmërinë e institucionit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat

Qëllimi i menaxhimit të vazhdimësisë, është të mirëmbahen kërkesat e vazhdimësisë së institucionit. Menaxhimi i vazhdimësisë përfshin rishikimin periodik dhe azhurnimin e afatit të rimëkëmbjes për të siguruar që ato janë në përputhje me Planet e Vazhdimësisë së Biznesit. Vazhdueshmëria a biznesit është procesi që një institucion ndjek për të planifikuar dhe testuar rimëkëmbjen e operimit të saj pas një ndërprerjeje.

Auditimi mbi planin e vazhdueshmërisë së biznesit u bazua mbi VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar, risqeve të identifikuar dhe praktikave më të mira. Referuar kësaj VKM-je: “Çdo institucion i cili ka ose do të zhvillojë sisteme në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbime për qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbimit të informacionit për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të realizojë investime për krijimin e sistemit të vazhdueshmërisë së punës (Business Continuity) dhe sistemit të ruajtjes së informacionit (Backup), me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimit pa ndërprerje dhe parandalimin e humbjes ose të shkatërrimit aksidental të të dhënave”.

RASH si institucion që ka si synim kryesor realizimin e një shërbimi sa më cilësor për arsimimin, duke synuar zhvillimin dhe përmirësimin e rrjetit kombëtar dhe shërbimeve SW për IAL, veprimtaritë kërkimore dhe arsimore për ta bërë sa më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri, që posedon sistemin Pitagora, Ualbania, Ucris etj., nuk ka marrë masa konkretisht sa më poshtë:

Nga auditimi u konstatua se: RASH nuk disponon dokument të planeve të vazhdueshmërisë së punës me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar. Këto dokumente përcaktojnë masat, procedurat dhe objektiva të mirë dokumentuara për rivendosjen në funksionim të sistemit në rastet e emergjencave dhe që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si dhe përcaktimin e RTO (*Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes*) dhe RPOs (*Objektivat e Punës së Ripërtëritjes*) për çdo proces kritik.

1. Titulli i gjetjes: Mos dokumentim i incidenteve, problemeve dhe ndryshimeve si dhe mungesa e plan veprimit për minimizimin e risqeve.

Situata: Nga auditimi u konstatua se RASH nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve, problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT. Në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti dhe mbështetja teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve. Institucioni nuk disponon procedura për iniciimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi për kryerjen e ndryshimeve.

Kriteri: Manuali i auditimit IT, praktikat më të mira.

Ndikimi/efekti: Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave.

Shkaku: Mos zbatim i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Rëndësia: E mesme

1.1. Rekomandim: Strukturat Drejtuese në Rrjetin Akademik Shqiptar të marrin masa për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve, problemeve si dhe menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.

2. Titulli i gjetjes: Mungesa e procedurave të backup-it dhe planeve të vazhdimësisë së punës me qëllim garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash.

Situata: Nga auditimi u konstatua se:

- Procedura e ndjekur për kryerjen e backup-ve nuk është e pasqyruar apo e dokumentuar në një dokument administrativ si Rregullore e Brendshme apo dokument tjetër TIK ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesi i ruajtjes së të dhënave për sistemet në përdorim nga punonjësit e RASH;

- RASH nuk disponon dokument të planeve të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar. Këto dokumente përcaktojnë masat, procedurat dhe objektiva të mirë dokumentuara për rivendosjen në funksionim të sistemit në rastet e emergjencave dhe që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si dhe përcaktimin e RTO (*Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes*) dhe RPO-s (*Objektivat e Punës së Ripërtëritjes*) për çdo proces kritik.

Kriteri: Standardet nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare (COBIT dhe Manuali i Auditimit IT). VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Humbje e të dhënave dhe risk për vazhdimësinë e punës dhe ndërprerjes së shërbimeve.

Shkaku: Mungesa e pajisjeve fizike dhe fondeve për të krijuar një qendër të dytë për sigurimin e shërbimit të vazhdueshëm në rast ndërprerje.

Rëndësia: E Lartë

2.1. Rekomandim: Strukturat drejtuese në RASH të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit dhe uljen e riskut për ndërprerjen e shërbimeve dhe vazhdimësisë së punës.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.2, datë 07.04.2023, protokolluar në RASH me shkresën nr. 152, datë 07.04.2023, si dhe është trajtuar në faqet 29-35 të Projektraportit të Auditimit mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe IAL-të, e kanë vendosur Rrjetin Akademik Shqiptar në kushtet e riskut të ekzistencës së tij, pasi nuk kanë financuar për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemeve informatike që j'u ka ofruar, në kundërshtim me VKM nr.88, datë 14.02.2018, në pikën 5 ku citohet se:

“Burimet e financimit të Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar janë:

c. kontributi vjetor i anëtarësisë nga IAL-të dhe institucionet e tjera;

ç. kontributi vjetor i ministrisë përgjegjëse për arsimin, i agjencive dhe IAL-ve, sipas shërbimeve përkatëse të ofruara”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 13-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Institucione e Arsimit të Lartë, si anëtarë të asamblesë së Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për të vënë në funksion të administrimit të tyre akademik dhe administrativ produktet informatike që janë zhvilluar nga RASH si asete të rëndësishme në drejtim të inovacionit dhe të bashkëpunojnë në mënyrë aktive në përmirësimin e tyre, pasi vetëm në këtë mënyrë do të mund të informatizojnë më shumë procese dhe me më pak kosto financiare.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi strukturën e ngritur të sistemit “Pitagora” u konstatua se:

- Përdoruesve të sistemit me kërkesë të tyre ju është dhënë aksesimi për fshirje të të dhënave nga ndërfaqja. Nga kjo e drejtë, krijohen disa problematika të cilat i adresohen për zgjidhje RASH-it, duke rritur nevojën për suport të shpeshtë në rikthimin e të dhënave.

Programi Pitagora është konceptuar dhe ndërtuar në mënyrë të tillë që kurrikula të lëvizet nga një program në një tjetër e gjithashtu t'i ndryshohet emri nëse është e nevojshme. Kjo do të thotë se veprimet e fshirjes nuk ka asnjë arsye të kryhen në sistem nga përdoruesit fundor që marrin këtë shërbim të cilët janë punonjës të universiteteve. Veprimi i fshirjes së Kurrikulës, në rastin kur është populluar me të dhënat e studentit, shoqërohet dhe me fshirjen e të dhënave të studentit/studentëve për këtë kurrikulë. Modifikimi i kurrikulës rezulton të jetë problemi më shpesh i raportuar dhe më me impakt tek të gjithë përdoruesit në lidhje me përdorimin e sistemit “Pitagora”.

Fshirja e kurrikulës ndodhë nisur nga fakti se mungon parametrizimi në sistemin Pitagora për lejimin e fshirjes, pasi nuk është bërë një ndarje e këtij veprimi sipas popullimit, në mënyrë që:

a. Fshirja e kurrikulës kur ajo sapo është krijuar, pra në kushtet kur të dhënat e studentit nuk janë populluar;

b. Fshirja e kurrikulës kur ajo është vendosur në programin e gabuar, por ka dhe të dhënat e studentit.

Nga auditimi mbi krijimin, plotësimin si dhe fshirjen e kurrikulës u konstatua se:

- Gjatë plotësimit të të dhënave në fushën “Mënyra e vlerësimit” është vendosur si një nga mënyrat dhe opsioni “Mbrojtje Anglishteje”, në vend të mbrojtje gjuhë e huaj duke qenë se MAS ka një listë gjuhësh të miratuara si të detyrueshme për programet studimore për tipin “Master”.

- Në krijimin e një kurrikule nuk përcaktohet tipi i saj nëse është “Provim” apo “Firmë”.

- Nuk shfaqet mesazh gabimi në rast se veprohet nga përdoruesi për ndryshimin e kodit të lëndës në modulën “Lëndët”, megjithëse ndryshimet nuk ruhen kur kodi i përket një lënde tjetër.

- Tek regjistrimi i elementëve mësimor në modulën “Programet” lista e elementëve është me shkurtime dhe jo emërtime të plota si: Leksion, Seminar, Praktikë, Ushtrime, Laboratorë, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 13-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Drejtuesit e institucionit të Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për sistemin e problematikave të konstatuara nga auditimi në modulën “Programe” të sistemit Pitagora. Gjithashtu, të ri konceptohet kodi i ndërtuar për fshirjen e kurrikulës duke mbajtur në konsideratë që fshirja të mos ndodhë në asnjë rast kur kurrikula është populluar me të dhëna për studentin, por të lejohen lëvizjet e saj në programe të ndryshme dhe modifikimet në të dhëna që lejohet ndryshimi.

Brenda vitit 2023

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi sistemin “Pitagora”, konkretisht në modulën “Studentët/Regjistrimi manual i studentëve”, u konstatua se:

- Në modifikimet e të dhënave për studentët e importuar lejohen të bëhen modifikime në të gjitha fushat përveç programit. Fushat, ku mund të jetë i nevojshëm modifikimi janë: mbiemri, numri i matrikullimit, e-mail, telefon, vendbanimi, gjendja civile.
- Fushat, të dhënat e të cilave zgjidhen nga një listë si “Programi” dhe “Gjendja e Studentit”, nuk janë të renditura sipas rendit alfabetik.
- Me zgjedhjen e gjendjes së studentit në fushën “Gjendja e Studentit”, nuk janë përcaktuar fushat tek të cilat mund të kryhen modifikime ose plotësime.
- Me zgjedhjen e opsionit “I transferuar” e cila tregon se studenti ka transferuar studimet nga një program në një tjetër, fusha që nevojitet të plotësohet është “Universiteti nga është transferuar” e cila nuk është e tipit listë, duke mundësuar që të dhënat të mos shkruhen në forma të ndryshme kur nevojitet të themi të njëjtin emërtim.
- Në listën e të dhënave të fushës “Gjendja e Studentit” janë vendosur disa emërtime në Italisht, kur gjuha e ndjekur në aplikacion është gjuha shqipe.
- Në fushën “Datëlindja”, ku plotësohet data e lindjes së studentit, nuk janë implementuar mesazhe informuese për përdoruesit në rastet e pasaktësisë në plotësimin e saj si shembull: data nuk është plotësuar në formatin e kërkuar, ose data e lindjes nuk mund të jetë më pak se 18 vite.
- Nuk janë implementuar kontrole kufizuese mbi karaktere speciale në fushat Emër, Atësi, Mbiemër. Plotësimi i këtyre të dhënave nuk mund të përmbajë karaktere speciale.
- Fushat “Shkolla e Mesme”, “Vendlindja” dhe “Shtetësia” nuk janë në formën listë, çfarë mundëson që të dhënat të mos shkruhen në forma të ndryshme për të njëjtin emërtim.
- Në të gjitha fushat që mund të modifikohen, mund të plotësohen me operatorët logjikë OR dhe AND.
- NID është një e dhënë e konceptuar si unike e cila nuk mund të ndryshohet pasi ka përfunduar regjistrimi i studentit, por kjo e dhënë është kërkuar të modifikohet nga disa universitete në rastet kur është regjistruar gabim apo është importuar nga të dhëna të sistemit të mëparshëm. Nga auditimi u konstatua se nuk janë shtuar kontrole paralajmëruese përpara ruajtjes së regjistrimit të studentit për të dhënë e NID si e dhënë e pandryshueshme, çfarë ndihmon përdoruesin të kontrollojë të dhënat e regjistruara.

Nga auditimi mbi modulën “Krijo Orar/ Orari Mësimor/ Orari jo periodik”, dhe në modulën “Krijo Orar/ Orari Mësimor/ Orari për përsëritës” u konstatua se:

- Në opsionin e krijimit të orarit të provimeve, nuk janë implementuar kontrole parandaluese mbi formatin e datës së provimit në modulën.
- Të dhënat që zgjidhen nga një listë si “Pedagogu”, nuk janë renditur sipas rendit.
- Tek orari periodik mund të plotësohen të dhëna mbi orarin mësimor, por aktualisht është një funksionalitet që nuk është vënë në përdorim nga universitetet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 13-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Drejtuesit e institucionit të Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për adresimin dhe zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga auditimi në modulën

“Studentët/Regjistrimi manual i studentëve” të sistemit Pitagora. Gjithashtu, të implementohen kontrole kufizuese të tipit “Error” apo informuese të tipit “Override” të cilat respektivisht parandalojnë apo njoftojnë për një kontroll të të dhënave që përdoruesi po regjistron, duke parandaluar gabime njerëzore e detyrimisht dhe nevojën për suport.

Brenda vitit 2023

4. Titulli i gjetjes: Nga auditimi mbi sistemin “Pitagora”, konkretisht në modulën “Evidencat”, u konstatua se:

- Universitetet nuk kanë kërkuar raporte mbi të dhëna të ndryshme si: plani mësimor, totalin e leksioneve, totalin e seminareve, totalin e laboratorëve, totalin e praktikave për javë mësimi si dhe për vit akademik, Orët jashtë orarit etj.
- Evidencat identifikohen nëpërmjet një kodi dhe emërtimi, por nuk ka një fushë përshkrimi ku të jepen detaje përshkruese mbi të dhënat që gjenerohen me secilin prej raporteve, çfarë do lehtësonte ngarkesën e sistemit dhe informim paraprak për përdoruesin.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 13-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Rrjeti Akademik Shqiptar dhe Universitetet që marrin shërbim për sistemin Pitagora, të bashkëpunojnë në ndërtimin e raporteve specifike dhe të bazuara në kërkesa konkrete dhe të mos mjaftohen me raportet e ndërtuara aktualisht, duke mbajtur në konsideratë faktin që për çdo të dhënë hyrëse në sistem mund të gjenerohet një raport, çfarë do ju shërbente më tej të gjitha palëve në analiza, statistika si dhe vendimmarrje.

Brenda vitit 2023

5. Titulli i gjetjes: Nga auditimi mbi sistemin “Mësues për Shqipërinë”, u konstatua se:

- Tek “Regjistrimi”, mësuesi hap llogarinë personale për herë të parë. Për ngarkimin e dosjes është konceptuar një fushë në të cilën bashkëngjitet duke upload-uar dokumentet që mësuesi dorëzon në aplikim. Për t’ju ardhur në ndihmë përdoruesve që në këtë rast janë mësues, është vendosur një tutorial i cili udhëzon në anglisht se si të bëhen “zip” dokumentet për aplikim, gjuhë e cila nuk njihet nga çdo mësues.
- Nuk janë implementuar kontrole mbi datën e lindjes së mësuesit që plotësohet në regjistrimin fillestar të tij, që do të thotë se të dhënat e datës së lindjes mund të jenë çfarëdo.
- Në fushat që plotëson mësuesi për Emrin, Atësinë dhe Mbiemrin nuk janë implementuar kontrole të karaktereve numerike apo speciale, pra këto të dhëna mund të plotësohen duke vendosur karaktere të tipit: ‘,/] etj.
- Fushat e detyrueshme nuk janë identifikuar me tregues specifik si “*” apo ngjyrë tjetër, e cila i tregon përdoruesit, se nuk mund të vazhdojë më tej pa bërë plotësimet e nevojshme. Për plotësimin e fushave të detyrueshme nuk janë implementuar kontrole me plotësimin e tyre hap pas hapi. Një kontroll është implementuar në butonin e fundit “regjistrohu”, që shërben për ruajtjen e aplikimit.
- Numri personal me numrin e pasaportës janë konceptuar në të njëjtën fushë, por këto dy numra nuk kanë të njëjtin format. Nisur nga kjo, nuk implementohen dot kushte parandaluese në hedhjen e të dhënave të sakta për formatin e NID-it dhe numrit të pasaportës.
- Nuk është vendosur një maskë orientuese për numrin që nevojitet të plotësohet nga përdoruesi si në rastin e datëlindjes.
- Me zgjedhjen e opsionit “Konfirmo s ‘kualifikimin / përjashtimin e kandidatit”, nuk ka një fushë të detyruar ku të jepen arsyet e refuzimit nga DRAP, të dhëna të nevojshme për DPAP-Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.
- Fusha “Shënim” është e njëjta fushë ku mund të shkruajnë apo ndryshojnë të gjitha nivelet e përdoruesve: DRAP – Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, DPAP- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe ZVAP- Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar. Pra, në këtë fushë shënimimi i kryer nga DRAP mund të ndryshohet nga DPAP apo ZVAP dhe

anasjelltas, çfarë pengon shënimet të mbeten si rekorde për efekt kontrolli apo gjurme në secilën nga fazat e vlerësimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 13-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Drejtuesit e institucionit të Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga auditimi në sistemin “Mësues për Shqipërinë”, me qëllim përmirësimin, strukturimin dhe unifikimin e të dhënave hyrëse, duke minimizuar në këtë mënyrë parregullsi të përdoruesve dhe nevojën për suport.

Brenda vitit 2023

6. Titulli i gjetjes: Nga auditimi mbi portalin “Mësues për Shqipërinë”, u konstatua se:

- Në adresën: <https://mesuespershqiperine.al/VendePune/Vende>, ku publikohen vendet e lira të punës, kërkimet nuk janë dinamike dhe të pavarura nga njëra tjetra. Nuk është e mundur që të kërkohet mbi vendet bosh të punës në bazë profili, pa përcaktuar DRAP. Gjithashtu, nuk është e mundur të bëhet kërkim në bazë profili pa zgjedhur më parë ZVAP. Nga testimet u konstatua se., kërkimi është i bazuar sipas renditjes: Cakto DRAP-> Zgjidh ZVAP->Zgjidh Profilin. Vetëm pasi të jenë plotësuar të dhënat sipas renditjes më sipër, mund të shfaqet një rezultat mbi kërkimin.

- Tek përmbajtja e njoftimeve, ku publikohen njoftimet e nevojshme në funksion të portalit “Mësues për Shqipërinë”, në adresën <https://mesuespershqiperine.al/Njoftimes>, adresat e internetit ku gjendet njoftimi nuk janë të lidhura që të hapen me një klikim, por vetëm duke i hapur këto adresa në një faqe të re kërkimi.

- Në hapësirën e quajtur “Këndi i Mësuesit”, informacioni udhëzues që jepet për të afishuar rezultatet përfundimtare tregon se të dhënat filtrohen sipas numrit personal me të cilin aplikanti është regjistruar në portal ose në mënyrë alternative me numrin personal të deklaruar në dosje, adresa <https://mesuespershqiperine.al/Home/Kendi>. Opsioni i dhënë në adresën e mësipërme tregon se një afishim të dhënash mund të bëhet duke vendosur numrin e letërnjoftimit, ndërsa teksti shpjegues sqaron se nevojitet të vendosni numrin personal ose numrin e pasaportës që keni deklaruar në dosje. Letërnjoftimi nuk është pjesë e të dhënave në dosje, prandaj ai nuk duhet të jetë në asnjë nga kërkimet.

- Përmbajtja dhe përgjigjet e pyetjeve më të shpeshta drejtuar përdorimit të portalit “Mësues për Shqipërinë” në adresën <https://mesuespershqiperine.al/FAQs>, në disa raste nuk është dhënë informacion i plotë dhe në mënyrë shteruese.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 13-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Drejtuesit e institucionit të Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për adresimin dhe zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga auditimi në sistemin “Mësues për Shqipërinë”, me qëllim përmirësimin, strukturimin dhe unifikimin e të dhënave hyrëse, çfarë do të minimizojë parregullsitë e përdoruesve, si dhe nevojën për suport.

Brenda vitit 2023

7. Titulli i gjetjes: Nga auditimi mbi sistemin “Portali i Trajnimeve”, u konstatua se:

- Tarifa e trajnimit është një e dhënë që plotësohet nga agjencitë kur shtojnë një rekord të ri për trajnimin i cili më pas publikohet në portal. Në këtë fushë mund të shënohen dhe tekst megjithëse me këtë të dhënë nevojiten të zhvillohen statistika nga ana e RASH.

- Gjatë regjistrimit mbi llojin e trajnimit mundësitë e zgjedhjes janë: i Drejtpërdrejtë, online dhe i kombinuar. Këto opsione megjithëse fikse dhe të dërguara nga KAPT- Komisioni i Akreditimit të Programit të Trajnimit, nuk rezultojnë të jenë pjesë e një liste nga e cila agjencitë të mund të zgjedhin po ata e plotësojnë këtë të dhënë manualisht.

- Orari i fillimit dhe Orari i mbarimit është i tipit tekst, ndërkohë që duhet të ishte “Time”.

- KAPT-i dërgon të dhënat për modulet si dhe të dhënat për agjencitë ku në disa raste janë në anglisht. RASH nuk ka ndërtuar një model “template” për plotësimin e fushave me të dhëna që

vijnë nga KAPT-i, duke përcaktuar në këtë mënyrë se cilat janë të dhënat e detyrueshme që nevojiten për sistemin e trajnimeve.

- Përdoruesit e të gjitha kategorive nuk gjenerojnë të dhëna si output/raporte.
- Në aplikimin për trajnim që kryhet nga mësuesi të dhënat hyrëse për emrin, mbiemrin dhe numrin personal janë formatuar në tipin tekst, që do të thotë se si të dhëna lejohet të regjistrohen karaktere speciale.
- Mesazhi që del në aplikimin e mësuesit për zhvillimin e një trajnimi është se “*Të gjitha fushat janë të detyrueshme për t’u plotësuar*”, por aplikimi mund të ruhet pa plotësuar të dhëna mbi Institucionin Arsimor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 13-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Drejtuesit e institucionit të Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për sistemin e problematikave të konstatuara në sistemin “*Portali i Trajnimeve*”, duke përmirësuar në këtë mënyrë strukturimin dhe unifikimin e të dhënave hyrëse e njëkohësisht duke minimizuar parregullsi të përdoruesve dhe nevojën për suport.

Brenda vitit 2023

8. Titulli i gjetjes: Nga auditimi mbi sistemet informatike që ka ndërtuar RASH si “*Pitagora*”, “*Mësues për Shqipërinë*”, “*Portali i Trajnimeve*”, u konstatua se mungojnë:

- Diagramet e qarkullimit të informacionit për proceset e ofruara nëpërmjet këtij sistemi të cilat njihen ndryshe si Workflow, të cilat përcaktojnë hyrjen e informacionit, përpunimin dhe raportimin e tij;
- Në mënyrë të unifikuar shenjat simbolizuese në të dhënat e detyrueshme që kërkohen dhe njihen si “*mandatory filed*”, tipet e të dhënave mbi datën, kohën si dhe të dhënat e tipit listë të përcaktuara për të dhënat që janë me zgjedhje.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 13-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Drejtuesit e institucionit të Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për zgjidhjen e problematikave të njëjta që janë identifikuar gjatë auditimit në sistemet *Pitagora*”, “*Mësues për Shqipërinë*” dhe “*Portali i Trajnimeve*”.

Brenda vitit 2023

9. Titulli i gjetjes: Nga auditimi u konstatua se RASH nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve, problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT. Në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti dhe mbështetja teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve. Institucioni nuk disponon procedura për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi për kryerjen e ndryshimeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 34-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandim: Strukturat Drejtuese në Rrjetin Akademik Shqiptar të marrin masa për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve, problemeve si dhe menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Titulli i gjetjes: Nga auditimi u konstatua se:

- Procedura e ndjekur për kryerjen e backup-ve nuk është e pasqyruar apo e dokumentuar në një dokument administrativ si Rregullore e Brendshme apo dokument tjetër TIK ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesi i ruajtjes së të dhënave për sistemet në përdorim nga punonjësit e RASH;
- RASH nuk disponon dokument të planeve të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1

shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar. Këto dokumente përcaktojnë masat, procedurat dhe objektiva të mirë dokumentuara për rivendosjen në funksionim të sistemit në rastet e emergjencave dhe që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si dhe përcaktimin e RTO (*Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes*) dhe RPO-s (*Objektivat e Punës së Ripërtëritjes*) për çdo proces kritik.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 34-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandim: Strukturat drejtuese në RASH të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit dhe uljen e riskut për ndërprerjen e shërbimeve dhe vazhdimësisë së punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT